Oral History Kosovo

INTERVISTË ME NIKOLLA JOVANOVICIN

Beograd | Data: 11 korrik, 2017
Kohëzgjatja: 136 minuta

Prisutni:

1. Nikolla Jovanovic (I intervstuari)
2. Marijana Toma (Intervistuesja)
3. Millan Petkovic (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:
() - komunikim emocional
{} - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:
[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin
Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Marijana Toma: Sot është 11. 07. 2017, intervistë me Nikolla Jovanovicin. Nikolla, unë do t'iu kisha lutur të na thuani datën e lindjes, vendin e lindjes dhe diçka rreth fëmijërisë dhe familjes në të cilën je lindur.

Nikolla Jovanovic: Hmm, pra unë jam Nikolla Jovanovic i lindur me 7 shtator, në vitin 1980 në Pejë, fëmija i dytë. Vëllau është dy vjet e gjysmë më i vjetër se unë, Dragolubi. Në Pejë kam jetuar deri në vitin '99, a po, deri në bombardime. Nuk di çfarë të tregojë rreth fëmijërisë. Edhe filloren dhe të mesmen e kam përfunduar në Pejë. E mesmja ishte bash, ksi, pak para përfundimit, në kohën, ksi, gjatë kohës së luftës, kështu që në gjysëm-vjetorin e fundit nuk kemi shkuar bash në shkollë, mirëpo…

Mirëpo, përveç kësaj e tëra çfarë më kujtohet, më kujtohet e vetmja banesë në të cilën kemi jetuar. Para kësaj kishim jetuar me një banesë tjetër mirëpo kjo nuk më kujtohet, kjo ishte kur kam qenë bash i vogël. Më kujtohet kjo banesë në rrugën "Muharrem Bekteshi". Nuk e di se si quhet sot, por është afër shkollës "Ramiz Sadiku". Kështu quhej para se të nisesha. Më pas e riemëruan "Desanka Maksimovic". Nuk e di, kam shkuar dy herë në parashkollor, po. Herën e parë pasi që isha i papërmbajtur, ksi, në shtëpi. Nuk më nxinte vendi vend dhe më regjistruan, dhe më pas herën e dytë për shkak se nuk mundeshin të më regjistronin në klasën e parë, dhe më pas shkova edhe njiherë që ta vërtetoj klasën. Më kujtohet që më vinte turp që kam përsëritur parashkolloren, mirëpo mirë pastaj në shkollë kam qenë vukovac[1] dhe e gjtha që vjen me këtë.

Nuk e di se çka më kujtohet, më kujtohet që sa i përket fëmijërisë më kujtohet mospërfillja, më kujtohet si jetonim në ato ndërtesa. E kemi pasur një oborr të bukur ku ka qenë një bandë fëmijësh. Më kujtohet që, tash në krahasim me mënyrën se si djali im rritet sot, që si tepër të vogël kemi mundur të dalim para ndërtesës dhe të luajmë pa pikë frike, nuk e di, nga vetura apo diçka tjetër. I kemi pasur të gjitha këtu në oborr. Kemi qenë, po, kjo ishte mjaft specifike, bash ka pasur shumë fëmijë në atë fqinjësi, dhe më kujtohet, themi për shkak të kësaj nuk kam pasur ndonjë lidhje speciale me vëllaun tim, në sensin që ne të shoqërohemi, që së bashku të rritemi, mirëpo ai kishte ekipën e vet, unë ekipin tim pasi që nga vegjëlia e kemi pasur këtë, secili të paktën nga dhjetë, pesëmbëdhjetë miq në oborr. Dhe, dhe kështu më pas të gjithë shkonim në drejtimin tonë. Më kujtohet që këtu para ndërtesës kemi pasur bash gjithçka. Edhe kosh, edhe futboll dhe volejboll. Të gjitha këto ne i kemi punuar vetë, i kemi

[1]Serb.: *Vukovac* është një emërtim kolokial për nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme të cilët kanë pasur notën mesatare 5.00 në fund të secilit vit shkollor. Për këtë sukses nxënësit në ish-Jugosllavi, dhe së fundmi në Serbi, kanë marrë diploma me emrin e Vuk Stefanović Karadžić, andaj dhe janë quajtur *vukovac*.

vendosur, kemi vjedhur shtylla nga, nga "Elektro-Kosova", shkonim të, të, të, kemi hedhur këtë, kemi prerë rrjeta, kemi bërë gjithçka të gjallë.

Shkollën e kisha menjëherë para shtëpisë. Këtë e… kjo ishte super. Shkolla me një oborr të madh dhe të bukur, dhe mburreshim shumë me këtë që e kishim oborrin shkollor më të bukurin, në të cilin kishim edhe një teren për futboll, një teren të madh për volejboll, një park të vogël, dhe këso gjërash. Kjo për mua ishte super kur isha i vogël, sepse kam mundur të vrapojë deri në shtëpi në kohë të pushimit, të ha dhe të kthehem mbrapa. Nuk di çka tjetër të shtojë.

Baba dhe nana, që të dy punonin në "Zastava". Baba është mekanik, nana kimiste. Ajo punonte në atë laboratorin për vajra dhe lubrifikantë në "Zastava", ndërsa baba ka qenë një ndër menaxherët, drejtorët, të drejtën t'ua them nuk e di. E di që në një kohë ua ka mirëmbajtur arkivin dhe që më vonë kur ka kaluar në një firmë tjetër ata nga "Zastava" ata e thirrnin që ai t'u tregonte. Ai e njihte tërë arkivin përmendësh e dinte ku, çka ishte. Gjyshja jetonte me ne, po, nana e babës. Ajo është kujdesur për ne qysh fëmi, nuk kemi shkuar në çerdhe. Më pas kemi shkuar në parashkollor unë dhe vëllau im.

Banesa kishte dy dhoma të gjumit dhe një kuzhinë, dhoma e ditës, dhe diçka tjetër, mirëpo ka pasur hapësirë për, për, për gjithçka. Ndërtesa në të cilën kemi jetuar ka qenë katërkatëshe, në secilin kat nga dy, po, dy banesa. Ishin, katër banesa kanë qenë të shqiptarëve, them, katër të serbëve. Kjo, kjo më ka lënë përshtypje që nga fëmijëria që kurrë nuk i kemi mbyllur dyert, bukfalisht, jemi rritur në shtëpitë e njëri tjetrit. Përballë neve ishin shqiptarët, së pari tek banesa e tyre unë dhe vëllau jemi rritur, dhe më vonë kur ata kishin fëmijë të vegjël, ata u rritën te ne.

Më kujtohet edhe kjo, kjo tash është diçka, më vonë kur e tëra filloi, pra të gjitha ato budallakitë e luftës, dhe njerëzit nxerrnin në pah detaje që ata janë kështu, ashtu, nuk kam lidhje. Më kujtohet, për shembull, që ata kurrë nuk i kanë bërë problem Valonit të vogël që tek ne hante mish derri. Nuk e di, sepse fëmija është fëmi. Ai kur të rritet, ai do të vendos vetë a do të bëhet kështu apo ashtu. Po, dhe te ne ka qenë njejtë, problemi i vetëm ka qenë që i kam keqtrajtuar vajzat e tyre që të pjekin pallaçinka non stop pasi që i adhuroja t'i haja, dhe kërkoja nga to, edhe kur ato më refuzonin prindërit e tyre i qortonin pse nuk donin, "Si po mundesh ta refuzosh?" Këto ishin problemet që më kujtohen, këto janë problemet e fëmiut në Pejë në një fqinjësi të tillë. Mirëpo, ndonjëherë bënim shumë zhurmë dhe shfaqej njëri i cili nuk e di, aktronte kryesuesin e Këshillit Banesor apo diçka të tillë, që nuk e kemi pasur kurrë, mirëpo ai e aktronte atë pozitë. Ai dilte dhe na ndjekte, na bërtitke, nuk e di, disa prindër diskutonin. Mirëpo, fëmijëria ma përkujton njëfarë mospërfillje.

Më kujtohet edhe kjo që madje edhe më vonë, kur fillova të ngas bicikletën, ndoshta i kam pasur dhjetë vjet apo njëmbëdhjetë, mirëpo nuk më kujtohet sakt sa i kisha, mirëpo më kujtohet që me njërin nga shokët e mi që kemi shkuar në Bajë të Pejës me bicikletë. Kjo është rruga magjistrale që deri aty i kishte 15 kilometra apo diçka ashtu. Askush kurrë nuk ma ka ndaluar apo të më thotë, edhepse ta them të vërtetën nuk e di nëse prindërit e dinin, sidoqoftë nuk më kontrollonin. Mirëbesimi… kurrë nuk e kemi pasur ndjenjën që duhet të kujdesemi nga diçka, si ta them, dhe krejt vonë kur ka ardhur koha atëherë përnjëheri na thanë që duhet të kujdesemi, Ok. Ja pra këtë e kujtoj nga fëmijëria, nuk e di çka tjetër kisha mundur të them.

Marijana Toma: Peja, si dukej Peja në ato vite për ty, nga perspektiva yte?

Nikolla Jovanovic: Nga ajo perspektivë, e madhe…. Tash besoj që ka qenë sa gjysma e Zemunit, lidhje nuk kam. Mirëpo, ka qenë e madhe. Më kujtohet që atëherë ka qenë, që për mua posaçërisht

tash që isha mësuar ta kem shkollën para derës së shtëpisë, dhe kur kam regjistruar gjimnazin, që tash duhej të shkoja në gjimnaz, tash nuk e di sakt sa, mirëpo ka qenë nji kilometër e gjysmë larg. Ashtu, kush ka me shku atje? Aq larg. Çdo ditë duhet të shkoj në shkollë dhe të kthehem nga shkolla.

Peja, ne gjithnjë e kemi dashur Pejën dhe Peja gjeneralisht është ashtu e vogël, atëherë ende… atëherë kemi pasur mini-ekskurzione tërë kohën edhe kur ishim në shkollën fillore. Shkonim nëpër Kosovë me autobus atje, këtu, kështu nëpër shpella, shkonim, nuk di, në Prizren. Nuk më kujtohet se ku krejt kemi shkuar dhe ne gjithnjë kemi qenë krenar sa e bukur është Peja. Dhe pasi që nëna ime është nga Mitrovica e Kosovës dhe aty e kalonim verën dhe dimrin, disa ditë aty te gjyshja dhe gjyshi, tezja. Dhe më pas më kujtohet që e ka pasur atë të hirtën industriale. Ne gjithnjë i zezatshim që prej se ka ndalur punën Trepça, ata për herë të parë kanë parë zogjtë sepse më parë s'kanë mundur për shkak të ajrit të ndotur. Mitrovica ka qenë shumë urbane, krejt me solitera, kjo-ajo, ndërsa Peja ka qenë e vogël disi e palume, e bukur. Ka qenë vetëm një soliter të cilin thjeshtë e thirrnim soliter, i cili ka pasë më shumë se dhjetë kate, nuk e di sa i ka pasur. Këto të tjerat kanë qenë ndërtesa me pesë, gjashtë, shtatë kate dhe neve bash na pëlqente kjo, dhe pamja kah Rugova.

Na pëlqente të shkonim, sidomos sa ishim në gjimnaz, të ikim nga orët dhe të shkojmë te Patriarshija dhe kur të na lejojnë, nëse ia arrijmë t'i mashtrojmë motrat e nderit që të na shesin atë verën e famshme të Patriarshisë, të ëmbël, e cila në fakt është e vetmja verë e kuqe që unë mund ta pi. Sepse mua nuk më pëlqen vera e kuqe, por ajo ishte disi e ëmbël dhe më shijonte. Dhe kur shkoje tutje nga Patriarshija nën Bistricë, po mendoj këto janë detalje tepër të bukura të cilave edhe sot iu kisha kthyer me shumë kënaqësi, dhe kur më pyesin, "Çka të kujtohet?" Më kujtohet kjo.

Dhe më kujtohet parku i Karagaçit, i cili është në qendër të qytetit dhe i cili është në kodër dhe nëpër të cilin kemi kaluar aq shpesh kur prej qendrës shkonim në sallë të, të, të basketbollit. Eh pra kjo është edhe një gjë e cila më kujtohet, klubi i basketbollit. Për shkak të tij me siguri edhe e kam dashur basketbollin, dhe për këtë kjo është arsyeja pse ende e përcjelli. Pasi që ishte "*Buducnost*" [Klubi Ardhmëria] e Pejës, e cila me të vërtetë kishte një ekip, sidomos në ato shtatë, tetë vitet e fundit, kur e tërë ekonomia lokale iu bashkua nismës, Karići, Rajevići, Labovići,[2] të gjithë kanë dhënë të holla, dhe e bërë një klub i cili shkonte nga liga në ligë. Ne madje udhëtonim me ta, po, si tifozë, si grup i organizuar. Më kujtohet kështu me shumë krenari, shkruante në gazetë një tekst i shkurtër mirëpo i bukur "Tifozët ultra giga, mega" kjo me të vërtetë më është dukur super.

Më kujtohet që njejtë, po, ky i cili është afër Pejës, për këtë tek vonë kam pasur respekt, tek kur disa njerëz të tmerrshëm e dogjën atë pjesë, pjesën e vjetër të Pejës që quhej rruga *Uska* [Ngushtë] dhe kjo është ajo pjesa ku është pazari dhe ajo xhamija e cila dikur ka qenë kishë, para asaj xhami, lidhje s'kam, me mijëra tregime i kemi dëgjuar për këtë dhe më nuk di çka është e vërteta. Mirëpo e tëra ajo pjesa e vjetër historike e cila ishte edhe e mbrojtur nga shteti, këtë e kujtoj mjaft mirë, sepse kjo disi e kishte atë shpirtin. Tek më vonë kur kam jetuar në Stanboll, disi të gjitha ato rrugicat më përkujtonin, ai bazari, bazaret gjithnjë më kujtonin në këtë. Kjo më ka mbetur në kujtesë. Dhe po, dhe jazi i famshëm që është një jaz ku shkojnë ujërat e ndotura, i cili për shembull ka kaluar në tërë qytetin si Dunav-Tisa-Dunav, pra që janë bashkuar. Tash kur mendoj unë nuk e kisha lejuar fëmiun tim që t'i afrohej, kurrë. Ne këtu, po mendoj ne laheshim në të, mirëpo aq shpesh kemi kaluar nëpër aty, dhe bije aty, unë nuk di si nuk na kanë rënë copë këmbët nga bërllogjet aty. Mirëpo, po, ai kalonte ashtu nëpër qytet, sikur i mbuluar, kryesisht njerëzit binin aty. Kjo më ka mbetur në kujtesë. Nuk e di çka tjetër, kjo është e tëra.

[2] Familje të njohura të biznesmenëve në Pejë para vitit 1999.

Marijana Toma: Më tregove që ke shkuar në shkollë në '87?

Nikolla Jovanovic: Ashtu i bie, në të '80-tat jam i lindur, po.

Marijana Toma: Shkolla quhej "Ramiz Sadiku"?

Nikolla Jovanovic: "Ramiz Sadiku".

Marijana Toma: Dhe më pas i ka ndryshuar emri. A shkonit bashkë në shkollë?

Nikolla Jovanovic: Po, në dy-tre vitet e para shkonim së bashku, mirëpo bashkë në ndërrime të ndryshme. Do të thotë kurrë nuk kemi pasur ndërrimet e përziera. Do të thotë, ata na thonin se kjo ishte thjeshtë sepse gjuhët ishin të ndryshme dhe që shumica e fëmijëve shqiptarë nuk flasin serbisht, e kinse është për këtë. Kemi shkuar me ndërrime, kur e mendoj tash, më kujtohet kjo dhe nuk ka qenë si serbët e shqiptarët, por këta të ndërrimit tjetër, nuk e di. Dikush ka gërrithur diçka në ulësen time, dhe unë e kam pritur pas mësimit që të shoh kush ka qenë ai, që unë t'ia spjegojë disa gjëra, që ai nuk mundet kështu në ulësen time, nuk di, e kështu.

Ne kemi mësuar njëjtë, tash unë nuk e di, nuk më kujtohet cila ka qenë klasa e parë, dytë, tretë, katërt, këtu diku, ne mësonim shqip në shkollë, në njërën nga vitet. Tash mua nuk më kujtohet a ka qenë kjo një program pilot, kam qenë shumë i vogël, mirëpo më kujtohet një fatkeqësi e një mësuese të cilës nuk i kujtohej se si i thuhet zogut në shqip dhe kështu diçka. Po mendoj krejt jashtë, nuk e di si kjo. Me siguri, po supozoj që kjo ka qenë ideja që këtu të mësohet diçka, që të na bashkojë, mirëpo shumë keq e realizume ka qenë kjo.

Më pas nuk e di pas cilit vit shqiptarët janë ndarë nga shkolla dhe i kanë bërë të vetat. Më kujtohet që këtë nuk e kam pasur të kjartë. Tash kjo njëmend, në shtëpi te unë, familja ime është një familje e vjetër pejane. Ky, gjyshi im të cilin nuk e kam njohur kurrë, ai ka vdekur kur babi i ka pasur 14 vjet, ai ka qenë rrobaqepës. Dhe ky, më kujtohet sepse ma kanë treguar me mijëra herë me krenari që ai ka qepur mantilat për manastirin e Deçanit, gjë që ka qenë një nder i madh në atë kohë, dhe për këtë arsye më vonë mua dhe vëllaun na kanë pagëzuar aty. Do të thotë një familje e vjetër, e cila pra, ne jemi rritur në këtë lloj mjedisi dhe në një familje ku, mendoj, me të vërtetë kurrë nuk kam ditur prej atyre miqve tanë se kush është shqiptar, kush është turk, kush është rom, kush është serb, unë nuk kam liidhje.

Madje as kush është serb e kush malazez, tek kur kam shkuar nga Peja e kam kuptuar që ne këtu e kemi një ndasi mes serbëve dhe malazezëve. Nuk kuptoja, tash çfarë serb e çfarë malazez, çka është kjo? Dhe kështu, kam ca miq të cilët janë zhvendosur në Beograd dhe flasin malazezisht. Eh tash, po, ne kemi pasur njëfarë akcenti atje poshtë në Pejë, i cili i afrohej akcentit malazez, dhe tash çka, mirëpo mirë? Këto ndasi ndodhin ndonjëherë më vonë ose njerëzit i zgjedhin, ku ta di unë. Ashtu siç kam zgjedhur unë ta humb akcentin, po, po, po të flas, hajde po ia them si beogradçe, nuk kom lidhje.

Mirëpo çfarë desha të them, më kujtohet, më kujtohet që kemi jetuar në një shqëri shumë multi-etnike, shumë miq, të vjetër të familjes, nuk e di mirëpo kurrë nuk e kemi pasur atë ndjenjë që, që dikush nga ky lloj apo ai tjetër, ku ta di, nuk kam lidhje. Baba ka folur rrjedhshëm shqip dhe nuk na ka detyruar të mësojmë, mirëpo kohë pas kohe na ka bërë me dije që do të ishte mirë ta dinim, pasi që jetojmë këtu. Unë për fat të keq kurrë nuk e kam mësuar, e kam kuptuar të tërën sepse thjeshtë ne

shoqëroheshim, kjo-ajo, mirëpo presioni ka qenë mbi fëmijët shqiptarë që të dijnë serbisht më shumë se mbi ne, dhe ata dinin më shumë. Tash edhe ata të cilët nuk kanë folur edhe ata kanë kuptuar serbisht, kështu që ne kuptoheshim kryesisht, mirë kështu ka qenë. Unë tash këtë e shikoj përmes atij oborri të shkollës, i cili përfaqëson më së miri këtë. Dhe po, më kujtohet që tek ma vonë, në fillim ne e dallonim njëri tjetrin se cili është futballeri apo basketbollisti më i mirë, nuk kam lidhje, e jo cili është prej cilës [etni]. Më vonë më kujtohet që në të '95-tat, '96, '97 kishte edhe të tilla, ekipe të përbëra vetëm nga lojtarë shqiptarë dhe vetëm me serb. Madje mendoj se as që kemi luajtur, mua të paktën nuk më kujtohet, që kemi luajtur ndeshje kundër njëri-tjetrit, por më shumë të ndarë kemi qenë në oborrin e shkollës. Ata luajnë atje, ne luajmë këtu, kështu disi.

Dhe atëherë sinqerisht nuk e kam kuptuar çfarë po ndodh, po. Ti dëgjon nga anash, do të thotë në një moment kur veç e tëra filloi, nuk e di, kur filluan raportet e para mediale që një polic është vrarë në një fshat dhe kjo është tashmë në të '96-tën, '97, themi, po diçka ashtu '96, '97. Më kujtohet kjo dhe më kujtohet njëfarë frige e hidhur e cila kishte përshkuar njerëzit. E çfarë do të ndodhë, çfarë do të thotë kjo? Më herët ka qenë, kanë qenë ato demostratat, po. Më herët, më kujtohen këto nga fëmijëria, më kujtohet që prindërit më kishin thënë të rri në shtëpi gjatë atyre dy orëve deri sa të kalojë, dhe lidhje nuk kam për çka kanë qenë ato demostrata. Më kujtohet që disa shqiptarë kishin dalë me "V" [dy gishta] dhe kishin parakaluar në rrugë, më kujtohet që policia i kishte ndjekur këtej lagjës sonë, mirëpo për çka ka qenë kjo? Sinqerisht nuk kam lidhje. E kuptoj tash çka ka qenë, por sakt datën nuk e di, sakt çfarë ka nxitur ato protesta apo çkado, bash lidhje nuk kam.

Kemi qenë goxha mirë të mbrojtur në këtë aspekt, por edhe fëmijë ishim, mendoj s'ka çka këtu. Edhe poqëse do të ma kishin spjeguar me siguri unë këtë e kisha harruar. Më vonë kur kjo nisi pak më seriozisht më kujtohet ajo frikë e cila u kishte hyrë njerëzve. Ne në shtëpi kurrë nuk kemi folur për këtë. Po mendoj, nuk kemi folur shumë se çfarë domethënije kishte apo nuk kishte kjo. Babi na ka treguar me vepra çfarë mendon ai për tërë këtë, ai ka…. Po, ai ka rrezikuar shumë në të '88-tat, '89 që nga "Zastava" kishte kaluar tek [biznesi] "Karić", të cilët tek atëherë kishin nisur firmën dhe i kishin ofruar të merrte pozitën e drejtorit në Pejë për ato fabrikat e tyre, dhe më kujtohet që të gjithë i thonin, "As mos të shkojë mendja! Ti je çmendur, frimë private, a je ti normal?" Ai ka rrezikuar dhe kjo i është shpërblyer dhe për këtë arsye në të '90-tat ne kemi jetuar goxha të mbrojtur, nuk kemi menduar për këtë, për inflacionin. Po mendoj, po kemi menduar, por jo aq sa të mendosh nëse vlera e rrogës do të jetë dy euro. Ai e ka marre rrogën në deviza dhe kjo për ne ishte super. Eh, po më kujtohet kur ai, po, kur kaloi që tash… jam hutuar dhe nuk di për çka isha duke folur.

Marijana Toma: Flisje për fëmijërinë, për shkollën…

Nikolla Jovanovic: Tash u nisa diçka me tregu dhe m'u kujtua baba mirëpo nuk e di për çfarë arsye. Ah, po, me vepra na ka treguar këtë desha ta them, me vepra na ka treguar që në mesin e krejt kësaj, nuk e di, disa prindër të tjerë i largonin fëmijët e tyre, kishte raste të tilla që i largonin fëmijët e tyre për disa muaj jashtë qytetit sepse nuk e dinin dhe flitej se shqiptarët do ta sulmojnë Beogradin, po mendoj Pejën dhe çka po di unë, ai e ka ndërtu shtëpinë atëherë. Ai e ka investu të gjitha kursimet që i kemi pasur dhe nuk i kemi pasur, në ndërtimin e shtëpisë familjare në dy kate dhe nënkulm. Edhepse e ka ditur që ne do të shkojmë në studime dhe ka qenë pyetje nëse do të kthehemi në Pejë, ndërsa ai e ka ndërtuar që të kemi shtëpi familjare dhe që të kemi ku të kthehemi. Dhe e ka ndërtuar ashtu siç duhet. Podrumin, një kat të madh, edhe një tjetër, edhe një, nënkulm, oborr të madh, çmenduri! Dhe më kujtohet që baba dhe nana tërë kohën grindeshin. Ajo mundohej ta bindte ta blente një banesë në Beograd që ne të kishim ku të studiojmë, etj. Jo, ai dëshironte këtu dhe kjo ishte e tëra. Dhe më pas ne e kishim këtë ndjenjën që po, baba është njeriu më i mençur në botë dhe ai thjeshtë e dinë çka do të

ndodhë dhe kjo është kjo. Edhe pas bombardimeve kur ishin, njerëzit iknin masivisht, ai qëndronte dhe bënte zhurma duke e punuar në kulm e s'di çka. Njeri i çmendur…. Kur ta shikon këtë [intervistë] ai do të qesh me siguri.

Kështu që e them, ne kemi qenë të mbrojtur në këtë aspekt dhe disi nuk e kemi pasur këtë ndjenjë, në shtëpi nuk kemi folur për këtë që kjo është diçka e tmerrshme dhe që dikush po mundohet të na dëmtojë apo diçka. Thjeshtë ishin disa ndodhi që do të, do të kalojnë, do të kalojnë, do të vazhdojmë jetën ashtu siç ka qenë. Dhe me të vërtetë derisa nuk ka ardhur te bombardimet, nuk ishte diçka e tmerrshme. Do të thotë kohë pas kohe kanë qenë disa serbë dhe shqiptarë, tash po flas për moshatarët e mi, fëmijë të cilët kanë kështu dhe ashtu. Kanë qenë disa që përnjëheri janë trimëruar, dhe që janë, njëri ka qenë prej shokëve më të ngushtë nga fëmijëria, me të cilin diçka jemi grindur në oborrin e shkollës dhe ai ka bërtitur, "Pesëqind vjet, pesëqind vjet keni qenë ndër ne dhe prapë keni me qenë ndër musliman". Nuk e di, më kujtohet që ne kemi qeshur aq fort me këtë, sikurse tash, po. Unë gjithnjë jam shoqëruar me këtë grup, me të cilën nuk e di, nuk ka pasur këso gjërash, nuk kam lidhje. Ka pasur, po mendoj, mos të gënjej tash, ne kemi folur për këtë, nuk e di kur i kemi pasur 15, 16, 17 vjet, thjeshtë kjo ndodh rreth teje dhe ti flet për këtë. Dhe ka pasur, ka pasur këtu tregime të ndryshme dhe qëndrime, mirëpo në fund të fundit të gjithë kemi menduar që kjo do të kalojë dhe që do të vazhdojmë jetët tona dhe kjo është e tëra.

Marijana Toma: Kush ka qenë shoku yt më i mirë? A e ke pasur atëherë atë shokun më të mirë apo shumë shokë të mirë?

Nikolla Jovanovic: Uh, po shumë prej tyre shokë të mirë. Aq ishim të afërt sa që unë nuk di. Nga fëmijëria e hershme, si fëmijë, këtu para ndërtesës ishim shumë. Ka qenë fqinji i parë Vllado, i cili është gjeneratë e imja, që nga foshnjorja kemi qenë. Në fakt nuk ka qenë nga foshnjorja, nga klasa e parë kemi qenë së bashku në shkollë. Këtu ka qenë edhe Llekica, i cili… prindërit e tij kanë qenë të mençur dhe ishin shpërngulur më heret. Ata për shembull në '96, '97 kanë shkuar në Çaçak, Aleksandri, Llekica. Kështu, më vonë këtu kanë qenë Vllado Samarxhiqi dhe Rasho. Me Vlladon tash më rrallë shihem sepse nuk është në Beograd, thjeshtë jeta na ka shkuar në drejtime të kundërta, ndërsa me Rashën ende shihemi. Tash jetojmë më afër se sa që kemi jetuar në Pejë. Ashtu ka ndodhur, ashtu që me të ende takohem. Kemi pasur të tjerë në fqinjësi, kështu shumë herët në fëmijëri Shpëtimin e kam pasur super shok. Me të kam luajtur futboll. Atë të gjithë e kemi adhuruar sepse shumë mirë ka luajtur futboll dhe thjeshtë ka qenë super me pasë në ekip. Ai ka qenë super dhe e kemi pasë një super ekip në flipernicën pas ndërtesës dhe ka pasë mjaft prej tyre. Toni i cili ka vdekur në një fatkeqësi papritmas, nuk e di me 14, 15 vjet. Ai ka qenë një shok i mirë. Hari i vogël, unë mendoj se e ka pasur emrin Hari, edhe ai ka qenë një futballer tepër i mirë, edhe atë e kujtoj mjaft mirë, mirë por…

Po, ndërtesa pranë, pak më vjetër se ne, vëllau i Shpëtimit, Goni, ai na mbronte. Ai më ka mbetur mirë në kujtesë. Ai na mbronte shpesh nga këta më të vjetërit, të cilët na ndjeknin që të mos luajmë basketboll, dhe ai iu vërsulej shpesh. E kemi pasur një ekip shumë të mirë të cilin shumë e kam dashur, dhe me ta ende jam në kontakt përmes Feacebook-ut, tre vëllezër, ata janë shqiptarë, katolik, tri banesa, tri hyrje, dhe ata kanë qenë në hyrjen e djathtë. Iliri, më i riu, i cili është fotograf, dhe si quhej, Tom është… Iliri është më i riu, Tom është më i vjetri dhe Didi është i mesmi. Nuk e di si e ka emrin, por Didi, ai tash është diku në Zvicërr. Ata i kam adhuruar, pasi që ai merrej me muzikë për vetura apo nuk e di çka me të gjithçka ka qenë e mundur. Unë e kam adhuruar elektronikën dhe gjeneralisht kompjuterët si i vogël, dhe tek ai gjithnjë kemi mundur të shikojmë diçka, me përzi najçka, kështu që ka qenë super. Por, po, miqtë më të mirë përgjatë tërë fëmijërisë, eh pra katër kisha mundur t'i ndajë, Vllado, Llekica, Rasho, edhe ky Vllado tjetër.

Marijana Toma: Shpesh e përmend sportin dhe që të ka pëlqyer të përcjellësh sportin dhe basketbollin. A ke ushtruar ndonjë sport?

Nikola Jovanovic: Paj kam provuar të gjitha, por unë kam qenë… unë tash dukem shumë më ndryshe nga atëherë. Unë kam qenë shumë i shkurt, tek kur jam regjistruar në shkollë të mesme jam rritur pak, kam qenë kaq {tregon me duar} dhe i kam pasur 30 kilogram deri në shkollë të mesme. Unë kam ushtruar futboll dhe basketboll edhe s'di çka tjetër, krejt çka kemi pasur aty, karate e çka jo tjetër. Dhe shumë shpejt heqja dorë. Basketbolli më interesonte shumë, unë shumë heret e kam kuptuar që nuk është për mua. Sidomos, po, më kujtohen ushtrimet e para në të cilat shoku im më ka dërguar dhe tash më kujtohet që trajnuesi ma dha topin që të luaj 45 minuta nga dora e majtë në të djathtën. Dhe më tha, "Çka po mendon që është treningu?" Në rregull kjo nuk po më interesojka.

Futboll, njejtë një nga miqtë e mi të fëmijërisë, ky Dragani, i cili më vonë vdiq në masakrën e "Pandës", ai ka ushtruar futboll tërë fëmijërinë dhe ai njëherë më mori në ushtrime, dhe aty e kam kuptuar që ata vrapojnë përgjatë tërë ushtrimeve, nuk e di sa kruga rreth Karagaçit. Bukfalisht, kjo thjeshtë nuk ishte për mua, unë doja të luaja futboll. Po, por më pëlqente kjo, neve thjeshtë, ne nuk kishim argëtim tjetër. Pra, e kemi pasur këtë oborr të shkollës dhe këtu e kemi kaluar tërë kohën. Më pas, biciklizmi ka shënuar pjesën më të madhe të jetës sime atje 'poshtë',[3] sepse unë bashkë me Llekicën, ne i ndreçshim bicikletat dhe nuk e di, i lyenim, nuk kam lidhje çka krejt bënim, por i kishim edhe lojërat tona, ato gozhdat e vogla, dhe më pas i vendosshim ato llastikat dhe e bëjshim njëfarë fliperi, kjo ajo. Në tërë këtë, ai ka dhënë idetë kreative. Ai është mjeshtër, ksi, mjeshtër i lindur, ndërsa unë e kam përcjellur dhe bashkë kemi dalë me bicikletë. Ne thjeshtë shkonim çdoku me bicikletë, përmes Karagaçit famëkeq e deri te Patriarshija, kjo na ishte, hajde po shkojmë përmes Kapeshnicës sepse askush nuk të këshillon të shkosh aty sepse nuk e di, jetojnë arushat, çka po di me çka na kanë mbushur kokën atëherë, dhe e di që biciklimi ka qenë shumë më i rëndësishëm se krejt ato. Ndërsa në basketboll jam dashuruar për shkak të klubit, atij fanatizmit dhe atyre udhëtimeve. Njeriut i pëlqen diçka dhe aty e kishim. Po të kishim klub të mirë të futbollit, ndoshta kishte me qenë futbolli, nuk e di.

Marijana Toma: Cili ka qenë basketbollisti më i dashur në atë kohë?

Nikola Jovanovic: Shiqo, në atë kohë ne e shiqonim NBA[4], më së shumti përmes satelitit dhe inçizimeve në kaseta e krejt ato, mirëpo prej tonave ka qenë definitivisht "Partizani", gjenerata '91, '92, logjikisht Xhorxheviqi[5], Danilloviq[6]. Më kujtohet, mua më kujtohet si të gjithë kanë qenë të dashuruar në Xhorxheviqin për shkak të asaj treshës, ndërsa unë e kam adhuruar Danilloviqin, sepse ka qenë i paftyrë, që askush s'ka mundur asgjë t'i bëjë. Më vonë e kam përcjellur edhe pse nuk ka qenë lehtë të vijsh deri te ato ndeshje kur ai kaloi në Itali në "Kinder", nuk ka qenë lehtë të kemi qasje mirëpo jam gjindur disi. Ai ka qenë, bash, bash më i dashuri, mirëpo ky ka qenë një komunitet, një *community* [në anglisht] i vogël i njerëzve të cilët e kanë dashur basketbollin.

---

[3] Poshtë, është formë derogative si i referohet Kosovës, përfytyrim gjeografik që e paramendon Kosovë poshtë nga Beogradi dhe Beogradin në qendër.

[4] NBA, *National Basketball Association*, një ligë profesionale e basketbolli nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një nga ligat më të fuqishme në botë.

[5] Folësi e ka fjalën për Aleksandar Saša Đorđević, një basketbollist i famshën i përfaqësueses serbe dhe Jugosllave në basketboll.

[6] Folësi e ka fjalën për Saša Danilović, një basketbollist i famshën i përfaqësueses serbe dhe Jugosllave në basketboll.

Më kujtohen miqtë tonë të shtëpisë, Malishiqi dhe djali i tij Bojan, i cili ka qenë dy-tri vjet më i vjetër se unë. Ne kemi shkuar shumë te ata dhe ai njejtë ka qenë adhurues i basketbollit dhe unë nga ai kam mbledhur informata rreth NBA dhe ai ka luajtur një rol të madh që unë ta adhuroj basketbollin, jo vetëm ta përcjelli, mirëpo më shumë se aq. Më kujtohet që ai tërë kohën furnizohej me lojëra që kishin lidhje me basketbollin dhe ato i luaja tek ai dhe që nëse mund ta theksojë prapë "Partizani" është ekipi, kjo është kjo.

Marijana Toma: Do të kisha kthyer prapë në atë periudhën e hershme të rinisë. Ti e ke përfunduar shkollë fillore më '94, apo?

Nikola Jovanovic: Ashtu i bie.

Marijana Toma: Apo '95-tën, dhe më pas je regjistruar në të mesmen. Tash kjo është një periudhë kur fillojnë turbulencat në shoqëri. A të kujtohet diçka nga kjo periudhë? Çfarë të kujtohet?

Nikola Jovanovic: Paj vitet e para në shkollë, më kujtohet, a din sa më kujtohet? Më kujtohet që përderisa ne shkonim në shkollë ne kalonim kah ato shtëpitë, villat e mëdha ku shqiptarët shkonin në shkollë. Dhe tash ne nuk takoheshim, as nuk përlesheshim, apo ndjekeshim, as asnjigjë. E di që ne kemi komentuar pse u duhet atyre të shkojnë në këto shkolla. Më kujtohet edhe kjo që ne në atë kohë tashmë e dinim që ata e kanë zgjedhur këtë pasi që ata dëshironin ta mësonin historinë e tyre paralele, e cila nuk ka qenë e vërtetë, e cila nuk ka qenë e lejuar dhe të gjitha këto, dhe ata për këtë kanë vendosur. Dhe më kujtohen tregimet e ngjashme, kështu na e shpjegonin neve që atyre po ua mbushin kokën me lloj lloj budallaki për t'i përdorur për arsye të cilat nuk i di, duan ta ndajnë Kosovën apo nuk kam shumë ide.

Këto kanë qenë imtësi të cilat nuk më kanë interesuar t'ua them sinqerisht. Mua më interesonte se si nesër do të… a do të shkojë në [lëndën] e kimisë apo jo, a do ta marrë njish apo jo, a do të vijë baba në shkollë, dhashtë Zoti jo, të më keqtrajtoj. Ai aq shumë kishte dëshirë të më keqtrajtonte kur vinte në shkollë dhe të më sillte para mësuesve nga orët e të cilëve kisha ikur, dhe që t'ua spjegojë mësuesve para tij për çfarë arsye kam ikur nga orët. Ndërsa unë, pasi që isha gjeniu i vogël për kompjutera, këta në atë kohë kishin blerë kopmjuterë për shkollë, unë kisha marrëveshje super me drejtorin e shkollës, madje që unë ta udhëzoja se si të punojë në kompjuter dhe ai të m'i arsyetoj mungesat në orë kur më duhej, e këso gjërash. I kam pasur edhe marrëveshjet tjera me disa arsimtarë, mirëpo s'ka lidhje, por baba nuk ka qenë shumë dashamirës i gjithë kësaj, si ta them, ksi… Ai thellësisht ka besuar në sistemin tonë të arsimit, ai thoshte, "Shkolla duhet përfunduar, fakulteti duhet përfunduar, ushtria, pastaj bëj çfarë të duash". Më vonë ai e kuptoi që më e rëndësishmja është që unë ta udhëtojë botën dhe të mësojë gjuhë, dhe këto, mirëpo kjo ishte shumë më vonë, kështu që deri në atë kohë bash më ka keqtrajtuar.

Kështu që nuk më kujtohen këto tensione të këtij lloji. Pra ka pasur prej atyre, ka pasur tregime, kishte kur filluan të shpërfaqen tregimet për gjuajtje me armë, u vra ai polic, ky polic. Kjo ishte, mendoj, filluan tensionet. Çka më kujtohet ma s'pari që me të vërtetë ka qenë tmerr dhe më '98 filloi të bëhet më serioze dhe më kujtohet një detaj se si kam shkuar në dyqan lokal, te një shitës i perimeve te i cili kisha blerë gjatë gjithë jetës dhe i cili më njihte, ai më tha që nuk më kuptonte kur flisja në serbisht dhe insistonte që unë të flisja në shqip. Kjo më kujtohet, tash kjo më duket, mendoj më kujtohet që jam kthyer në shtëpi dhe u kam thënë prindërve, "Mirë, mirë ka lloj lloj budalle mos ia vno veshin. E kemi një këtu, s'ke nevojë të shkosh te ai dyqan, shko në këto tjerat".

E dini si, Peja ka qenë… dhe tash kjo më kujtohet dhe posaçërisht në të '90-tat në kohën e inflacionit dhe të gjithave, Peja ka qenë mirë e furnizuar. Do të thotë ne shumë rrallë kemi pasur mungesë të ndonjë gjëje. Pra, Peja është një qytet tregtar. Ne nuk kemi pasur industri të mëdha, mirëpo kemi pasur fabrikën e "Zastavës", fabrikën e baterijave, çka po di, mirëpo nuk ka qenë këtu, qyteti nuk është varur nga kjo. Pra, ky ka qenë një qytet tregtar dhe i kemi pasur të gjitha, është shfercuar nga të gjitha anët, dyqanet e perimeve kanë punuar, kemi pasur pemë dhe perime. Më kujtohet që ne në Mitrovicë i dërgonim gjyshës miell, sheqer, çka po di, artikuj elementar ushqimor pasi që nuk kishin ku t'i blenin në Mitrovicë. Madje as të hollat nuk kanë qenë problem, mirëpo thjeshtë nuk kishe ku t'i blije.

Dhe tash ne i kemi pasur të gjithë këta tregtarë kanë qenë kryesisht shqiptarë. Edhe sot është ashtu, bukëpjekësi është shqiptar, burekxhija, ok, goranë. Këtu na ishte edhe pazari edhe një qendër e vogël tregtare të cilin e patën ndërtuar ku ishin dy lokale serbe dhe të gjitha ishin shqiptare, mirëpo e tërë tregtia ka qenë në duart e shqiptarëve ta them kështu. Dhe të gjithë ishin miq të mijë nga fëmijëria, pra të gjithë ata më njohin gjatë rritjes, të gjithë më kanë qarosur me qokollada, nuk e di, të gjithë ma mbyllnin një sy kur unë e gjuaja në korpë edhe një qokolladë që nana apo baba mos t'më shihnin, nuk e di. Tash përnjëheri ai të thotë, "Unë ty nuk të kuptoj", dhe diçka në shqip më thotë. Unë shkova dhe më kujtohet ndjenja e atij lëndimi dhe tërbimi në atë sekond, jo diçka e tillë si, "He nanën e shqiptarit", por diçka si, "Po kush je ti bre", ashtu diçka.

Dhe këtu diku janë ato tensionet dhe mua më kujtohen që natyrisht veç kishim në shoqërinë tonë, në atë të gjërin, kishim të ndryshë. Pra nuk ishin të gjithë nga familjet si e imja, ku mua tërë kohën ma kanë ngulitur në kokë që thjeshtë, ne jemi të gjithë të njëjtë, nuk ka tjetër. Miqtë tonë, çka t'i them tash dikujt, më kujtohet si baba im na kishte dëgjuar si pas ndërtesës tonë dikush kishte sharë dikend, i ka thënë diçka, "…të shqiptarit!" Këte ate, çka po di unë. Tash ai mua më tha, "Çka nëse vjen te ne ai miku ynë [shqiptar] ti do të flasësh ashtu me të? Nuk kuptoj". Dhe ai këtë ma ka përsëritur gjithnjë, mandej tek ne kanë ardhur njerëz të ndryshëm. Do të thotë nuk kemi pasur, nuk jemi shoqëruar parësisht me serb, edhe pse aty i kishim. Kompanija e babit tim ka pasur, po mendoj tek Kariqët [Karić] që kanë punuar, kishte, nuk e di sa të punësuar kanë pasur, mirëpo mendoj që i kanë pasur 75 përqind romë, dhe ata kanë qenë shumë krenar që kanë punësuar romë lokal dhe u ndihmonin atyre që ata të jetojnë nga kjo dhe ka pasur edhe shqiptar, nuk e di. Mua nuk më kujtohet që këtu ka pasur shumë serb, sinqerisht. Kështu që aty ka qenë shumë e përzier.

Tash, këtu kishte fëmijë të ndryshëm të cilët, ka pasur këtu edhe tregime si, "Nanën atyne, ne kemi atyre me ua ba kështu, ashtu, krejt ata duhet përzënë". Nuk e di. Pra tregime të ndryshme ka pasur këtu të cilat sot, ti si fëmijë nuk i konfronton ato. Unë tash nga kandvështrimi im, unë e di që fëmiun tim do ta mësojë të mos konfrontohet por të largohet nga aty, dhe t'ia spjegojë për çka është kjo gabim, por… Me gjasë edhe prindërit e mi nuk e paramenduar që kjo do të ndodh, dhe as që më kanë mësuar diçka ashtu. Ti ulesh aty dhe thjeshtë shuan dhe dëgjon krejt ato dhe diku në mendje të qëndron e tëra kjo. Mua për fat nuk më ka ndodhur, për mua kurrë nuk ka qenë e vërtetë, nuk më ka hyrë në mendje që dikush është i tmerrshëm vetëm pse është *Šiptar*[7], nuk kam lidhje.

Për mua ishte njejtë, unë e krahasoj, gjithnjë bëj paralele, kjo natyrisht varet në çfarë mjedisi je. Tash, unë kam qenë në një mjedis dhe kjo kështu ka qenë dhe të gjithë ishim fëmijë që duhej kaluar nëpër

[7] Term derogativ ndaj shqipëtarëve të Kosovës, i cili ka pasur qëllim të krijojë dallueshmëri nga shqipëtarët e Shqipërisë.

këto, kur je në pubertet ti duhesh të kalosh nëpër fazën e popullores. Ne atëherë të gjithë dukeshim si dizelash[8] të këqij. Ato trenerka të futme brenda, tmerr. Tash kur i shoh ato fotografi shqetsohna. Flokët e lyeme në argjent, ashtu lidhje nuk kam çka tjetër i kam bërë vetës dhe duhesh me kalu nëpër tërë këtë. Kur je në shoqëri ti i ndëgjon këto dhe të gjitha ato këngë i dinë. Në shtëpi je diçka tjetër. Në shtëpi, nën ndikimin e vëllaut kam ndëgjuar Public Enemy dhe Run-D.M.C., nuk kam lidhje, Ballasheviqin [Djordje Balašević] që prej gjithmonë, edhe sot e kësaj dite, mirëpo këto gjëra thjeshtë nuk i flet jashtë shtëpisë, në atë shoqëri ti je kjo. Nuk ke nevojë të flasësh rreth kësaj, mirëpo shuan dhe je aty. Dhe kjo e shikuar nga kjo perspektivë, unë këtë nuk e kisha bërë, mirëpo je fëmi dhe kjo është thjeshtë diçka nëpër të cilën kalon.

Më kujtohet njëjtë, kjo është një ndër gjërat më të tmerrshme, pak *fast forward* [Anglisht], kjo është një ndër gjërat më të tmerrshme që më kujtohen nga kjo periudhë, mendoj dhe dëgjoj vetën dhe e tëra kjo më tingllon idilike, por nuk është, sepse çfarë më turpëron më së shumti edhe sot kur '98, '99, s'po di bash cila kohë, qyteti ishte, madje në vitin '99 përgjatë bombardimeve ka pasur të tilla. Qyteti ka qenë gjysëm i zbrazur, pra ka qenë, më kujtohet që ka pasur luftime madje pranë Pejës, afër Brezhevikut, më kujtohet që qytetin e patën rrethuar gjysëm militarë të ndryshëm, si "Munja", "Legija" nuk kam lidhje, të gjithë ata që i shihnim si, nuk e din çfarë të presësh nga ta, nuk e din. Neve na thonë, po mendoj, neve askush nuk na tregonte që ato janë grupe kriminale dhe ti as që mund ta kuptosh, mirëpo ato thjeshtë janë njësi speciale të policisë. Dhe ti i sheh ata kinse ata po na e mbrojnë qytetin.

Sidomos e vështirë ka qenë pas "Pandës", sepse çfarë ka ndodhur në "Pandë" ka qenë diçka që na ka shokuar tej mase, mirëpo edhe para "Pandës" ka qenë kjo që ne, pasi që qyteti ka qenë i zbrazur, njerëzit kanë qenë të mobilizuar, edhe baba im ka qenë i mobilizuar dhe e kanë përjashtuar nga një grup i cili…. Dua të them, ata kanë qenë të stacionuar në një shtëpi të madhe të një pasaniku lokal shqiptar, dhe ata i kishin rrëmbyer në atë… ai ishte një grup vullnetarësh, që në fakt ishin të mobilizuar. Ata i kishin rrëmbyer *zepter* enët, këte, ate, dhe babi nuk ka dashur të jetë pjesë e kësaj dhe më pas ata i kishin thënë, "Po e shkruajmë që edhe ti je këtu, mirëpo ti shko në shtëpi". Më pas ai kishte shkuar në shtëpi, dhe ka qenë super i lumtur për këtë që nuk duhet të dijë për këtë dhe nuk duhet të qëndrojë aty. Babai tashmë ishte fytyrë e njohur në Pejë, atë e njihnin të gjithë, ishte drejtor tek Kariqët. Secili do të duhej ta njihte dhe jo vetëm pse tërë jetën kishte qenë aty, familje e vjetër e tjera.

Dhe tash, meqenëse qyteti kishte qenë i zbrazur, disa kishin shkuar nga qyteti, disa ishin mibilizuar, disa kishin, ksi aty-këtu kishin ardhur lajmet që ishin zënë disa automjete përplot me armë në rrugë për Kapeshnicë, në qendër të qytetit. Dhe më pas njerëzit kishin filluar të vet-organizohen ndër fqinjë, të mbajnë kujdestari. Dhe tash ata, dikujt sikur vetja ime që ka 17 vjet, i cili ka flokë të ngjyrosur, majicën e futur në trenerkë, i japin kallashnikov për të bërë kujdestari. Dhe tash ne jemi të gjithë, e gjithë ekipa, dhe gjitnjë e kishim dikë nga të vjetrit. Tash këta të vjetrit, po mendoj, i kemi pasur kishe do punkte ku kemi qëndruar, dhe ky i joni ka qenë me të vërtetë, ideja ka qenë që ne të qëndrojmë këtu që mos t'i bije ndërmend dikuj të shëtisë këtej pari. Zyrtarisht nuk ka pasur orë policore, mirëpo të mos i bie ndërmend dikujt, që ta dijnë që ekzistojnë punktet.

Eh, tash këta njerëz nuk e dijnë nëse jemi fëmijë apo jo. Ndoshta, po mendoj po ta dinin që jemi ndoshta edhe nuk do të kalonin sepse fëmiu është në gjendje të bëjë gjithçka. Dhe mua më kujtohet

[8] Pasanikët e rinj që ishin pasuruar shpejt si pasojë e derregullimit të ekonomisë së viteve '90-të. Ata janë karakterizuar me një mënyrë të veshjes, kryesisht me brende të shtrenjta sportive.

kjo, nga njëra anë them, të duket interesant sepse thjeshtë je fëmijë prej 17 vjeç dhe të duket interesant të mbash armë në dorë. Më kujtohet që baba më tha, "Shko, e di që duhesh, por mos u zezat, mos qit pahiri me plum në gyp, mos të bie ndërmend diçka, nëse ndodh diçka vetëm shtriju", nuk e di. Tash ne qëndronim në këto punkte, madje disa dëshironin që dikush të kalonte sepse kishte dëgjuar njëri që disa i kishin detyruar shqiptarët të bënin skleka në grila. Ka pasur tregime të tmerrshme këtu, mirëpo ka pasur, që mos të mos keqprezantoj, ka pasur djem që me të vërtetë na kanë spjeguar që nuk duhet të zezatemi, që po presim këtu që kjo të kalojë dhe të shkojmë në shtëpi dhe kjo është e tëra. Në mëngjes të presim tek kiosku të vije buka, të marrim bukë dhe të shkojmë në shtëpi dhe shënosh e mirë [në shtëpi].

Në atë kohë me të vërtetë ka qenë tmerr. Kjo është… tash rrënqethem kur e kujtoj të tërën, sepse më kujtohet si shkojmë në një rreth dhe përnjëheri e dëgjon një *krak* {onomatope} aty. Dhe të gjithë ngrihen dhe ti nuk e di çka është. Thjeshtë e ke kokën e mbushur dhe ti e ruan diçkajen nga dikush. Nuk ke ide se nga kush e ruan saktësisht, mirëpo ruan diçka nga dikush dhe tash diçka po dëgjohet. Dhe mendoj, ka pasur të tilla, ksi, ka qenë e tmerrshme. Më kujtohet që njëherë shetitnim rreth një ndërtese dhe njëri kishte gjuajtur një bocë këtu, dhe unë nuk isha i sigurt kush ishte, s'kisha lidhje çka është. Në ndërtesë kishte serbë dhe shqiptarë, a po na zezatë ndokush? A është nevrikosur ndonjë shqiptar dhe na ka gjuajtur? Dhe më kujtohet që dikush bërtiti në drejtim të ndërtesës, "Dil, he nanën", këte- ate, një tmerr i vërtetë.

Po mendoj, më vonë kur e kam kujtuar tërë këtë, unë këtë e kam ndrydhur, kam harruar, dhe një ditë jam ndeshur me këtë, unë kam pasur edhe fotografi. Çfarë kreteni duhesh me qenë me shkrep edhe fotografi me pushkë, po mendoj. Për fat aparatin të cilin e kam pasur ka qenë aq keq, dhe ato fotgrafitë e mija janë katastrof, mirëpo e di që janë nga kujdestaria para shtëpisë, me ata djemtë sa unë, të cilët kanë kaluar nëpër të njëjtën. Më kujtohet që fotografitë e tyre dolën në mediat e Prishtinës, kinse ata janë kriminelët lokal, ajo-kjo, në fakt fëmijë të moshës sime. Falë Zotit, media dashakeqe ka në të dyja anët, por prapë kur të mendoj, po bën fotografi me pushkë. Sa fëmijë mundësh me qenë, ksi….

Dhe më kujtohet që mua më vinte rëndë, sepse tash në ndërtsën tonë, tash më po flas vonë rreth bombardimeve, sepse kjo ka qenë përgjatë bombardimeve. Kjo në fakt më së shumti ka ndodhur përgjatë bombardimeve. Para kësaj ka qenë pak diçka, mirëpo unë nuk po mund ta kujtoj më datën, mirëpo po ka pasur bombardime, e di që një numër i madh i njerëzve nga ndërtesa jonë kishte shkuar tashmë. Po flas për shqiptarët, ksi… dhe më kujtohet që tash ne, prindërit e mi atëherë, po mendoj së pari miqtë, kolegët nga puna e babës e të familjes së tij për një natë kanë fjetur tek ne, pastaj baba i ka bartur diku, u ka ndihmuar.

Më pas pleqtë nga kati i parë, Azizi dhe… ia kam harruar emrin gjyshës, ata donin të shkonin dhe thjeshtë më kujtohet si ne e patëm barrikaduar hyrjen dhe që nuk i lejonim, në ndërtesë nuk u lejonim "tonëve" që të hyjnë. Po mendoj, tash them të "tonët", ata nuk janë të mitë, ata nuk i kemi lejuar të hyjnë sepse ata shkonin në pastrim dhe shikonin se kush është aty nëpër banesa. Ata [Azizi] thjeshtë nuk donin të shkonin dhe thanë, "Më vraj këtu. Nuk dua të shkoj. Unë i kam 80 vjet dhe nuk kam mundësi tjetër". Dhe më pas u kemi sjellë ushqimin dhe të tjerat. Mua më kujtohen tash të gjitha këto vështirësi, po. Kjo është nga njëra anë interesant sepse ti bashkë me ekipën tande kishe po e shetitë pushkën, po mendoj e din që asgjë nuk do të ndodh, e shetitë pushkën, dhe më pas të kujtohet kjo, më kalon nëpër kokë se si duhej pritur nesër në mëngjes për të marrë bukën edhe një tjegull me xhem, po mendoj kjo është disonancë kognitive. Nuk e di se çka po të ndodh. Tash e di çka është, por edhe që kjo quhet disonancë kognitive, tash e di por atëherë nuk e kam ditur.

Dhe më kujtohet ai fqinji ynë Dashiqi nga kati i dytë, i cili ka qenë mirë i armatosur, ai ka qenë disi pranë policisë dhe ka qenë i mobilizuar, më kujtohet si e kam takuar, duhet u bartur atyre ushqim dhe e takoj ate në hyrje dhe ai më pyet, "Ku je? Ku po shkon me ushqim?" Dhe unë për një moment nuk e di nëse duhet t'i tregoj, thjeshtë nuk e di. Edhepse unë e njihja atë tërë jetën, e di që është njeri i mirë, e di, e adhuroja e të gjitha, mirëpo nuk e di, nuk jam i sigurtë thjeshtë. Dhe më kujtohet që ai erdhi në shtëpi te na dhe tha, "Hej bre, jam unë. Fakti që kam uniformë…" kishe prit, ndalu. Dhe kështu kemi menduar që do të ndodh kur shqiptarët vijnë e ne shkojmë. Unë përgjatë bombardimeve, prindërit më dërguan që të më largojnë nga ato pushka dhe gjërave të tilla, më dërguan te vëllau në Beograd, i cili studionte dhe punonte atje. Dhe më dërguan, ka qenë një javë ditë që nga koha kur ata atij, pasi që telefonat nuk punonin të shumtën e kohës, ata i dërguan letër të cilën e kam lexuar unë në autobus, se hej Zot, të më mbajnë aty dhe të mos shkojë. Ku ka qenë tash logjika ime, kishe ku o njeri? Beogradin po e bombardojnë, Pejën nuk po e bombardojnë, kanë shkatërruar çfarë kanë mundur Karagaçin, kazermën dhe kjo ishte e tëra. Beogradin po e gjuajnë non-stop dhe në Pejë jam më i sigurt. Por ata natyrisht kanë pasur tjera mendime dhe këtë më vonë e kam kuptuar, dhe unë një javë më vonë kam gjetur transport dhe jam kthyer në Pejë dhe i kam shqetësuar. Dhe atëherë kam qëndruar.

Marijana Toma: Vetëm?

Nikolla Jovanovic: Po me një shok nga Peja, për të cilin e dija që ka ardhur dhe do të kthehet menjëherë. Ai e kishte sjellur një ushtar në spital dhe kthehej menjëherë, dhe unë u ula me të dhe u ktheva në Pejë. Mirëpo më duhet të them që kjo për mua ka qenë normale, po mendoj. Për mua, Beogradin nuk e kam njohur, këtu nuk e kam askend. Këtu e kam vetëm, një nga shokët e mi më të mirë Vllado Llonqareviqin i cili ka qenë i lënduar në "Panda", e kam pasur ate këtu, mirëpo kjo është e tëra. Familja është 'poshtë'. I ulur po shikoj lajmet në RTS[9], po mendoj çka po kërkoj unë këtu? Unë po shkoj 'poshtë' pashë Zotën, unë jam nga 'poshtë' dhe kjo ishte. Dhe më pas jam kthyer dhe 'poshtë' kam regjistruar fakultetin pak ditë para nënshkrimit të marrëveshjes së armëpushimit, pasi që ne nuk kemi pasur komunikim, askend s'e kemi njohur për të ditur kur e çka, e dishim që kjo do të kalojë dhe që duhet të regjistrojë fakultetin. Thjeshtë kjo është kjo kohë. Dhe erdha me dy palë shorce dhe tre maica dhe qëndrova ashtu. Dhe më pas këta të mijtë dërguan një veturë për mua, nuk e di me ca fotografi, pak rroba dhe ata qëndruan.

Tash prapë kjo, baba ka qenë i bindur që OK, ai është Pejan i vjetër, kush do ta prekte atë, nuk ka çka. Ne u kemi ndihmuan fqinjëve tanë, tash ata do të na ndihmojnë neve. Mirëpo çka nuk kanë llogaritur ata është që në Pejë nuk do të kthehen pejanët, por dikush tjetër, kështu që këta të mijtë kanë qenë të kidnapuar një javë ditë. Nuk i kanë dërguar në ndonjë vend por i kanë mbajtur në shtëpi. Nuk e kanë ditur, tash ky është fati në fatkeqësi, që baba ka qenë i njohur dhe që njëri nga ata që i kanë hyrë në banesë, ai ka pastruar dhe ai e ka njohur dhe me gjasë ka menduar se mund të fitojë diçka dhe i kanë mbajtur aty. Nuk ka pasur keqtrajtim fizik për fat, edhepse ata e kanë, e kanë terruar aty dhe këta kanë dëgjuar zhurmat para shtëpise, rrahjet, nuk e di çka krejt. Pra keqtrajtime fizike nuk ka pasur prej tyre por psikologjike po, edhe sot nana sa herë i bie dikush tavolinës me dorë, ajo shqetësohet.

Ata ia arritën të dalin nga ty, tash këtë nuk mund ta vërtetoj, baba kurrë nuk ka dashur të flet për këtë, por aty ka pasur para të përfshira, që ka pasur blerje, ashtu diçka. Ata tash kurrë nuk, nuk dëshirojnë të flasin për këtë. Unë madje besoj, tash këto janë bindje e mia personale, që Kariqët kanë paguar këtë pasi që ai ka qenë njeri i tyre, mik i tyre e të tjerë. Unë këtë po e lidhi kështu, pasi që për ta kishte

[9] Radio-televizija Srbije.

ardhur njëri prej njerëzve më të afërm të Sreten Kariq[10], vozitësi i tij përderisa kanë jetuar 'poshtë'. Dhe përafërsisht u kanë thënë, i keni gjysmë ore për t'u zhdukur. Dhe ata kanë paketuar diçka në atë *pick-up* [veturë me karrocë] dhe janë nisur dhe kanë shkuar deri te firma pasi që baba ka mbajtur në sef të gjitha ato, arin e nanës, nuk e di, kursimet, të gjitha. Mirëpo nuk kanë arritur, ka arritë te firma mirëpo aty kanë parë njerëz me pushka se si janë vërsulur në drejtim të tyrin dhe ata janë ulur në veturë dhe kanë ardhur këtu, dhe kjo është e tëra.

Marijana Toma: Njerëzit të cilët u kishin hyrë në banesë?

Nikolla Jovanovic: Nuk ishin ata, nuk ishin ata, këta ishin të tjerë, do të thotë prapë ka pasur një përballje, kush e di.

Marijana Toma: Në uniformë apo?

Nikolla Jovanovic: Jo, jo, ata ishin, eh tash nuk e di nëse kanë qenë në uniformë, apo grupe të vetë-organizuara. Ndoshta kanë pasur ndonjë mbulesë, ku ta di unë, mirëpo kanë qenë me maska, kanë qenë të tmerrshëm. Ata e kanë pastruar mahallën, njëjtë sikur këta "tanët" që kanë bërë kur ata shkonin nga shtëpia në shtëpi, prej banesës në banesë kanë pastruar dhe po supozoj kanë plaçkitur. Kjo ishte e njëjtë kur e kanë marrë babën dhe i kanë thënë, "Keni me mbetë gjallë mirëpo duhet të dorëzoni diçka nga armët". Tash baba nuk ka pasur asgjë në shtëpi, ai ka, ksi, ai ka pasur, e ka pasur një allti të cilin e ka mbajtur në sef, sepse e ka ditur që diçka do të mund të ndodh, dhe më pas ai i ka thënë atij që ka në firmë, pushkën e sigurimit. Ok, diçka duhet të japësh. Dhe më pas ky e ka vozitur atë, dhe kjo ka qenë marketing, e ka vozitur në tërë qytetin që ta shohin të tjerët që ky pastaj…

Në fakt ka qenë alarmi, "Pop Milko", kush është? Ai tash është në Beograd në Bezhaniska Kosa [lagje në Beograd të Ri], ai është ninxha i njohur "pop Milko", të gjithë e adhurojmë pasi që është shumë jokonvencional. Ai është veshur në uniformë dhe ka shpëtuar njerëz, bukfalisht i ka nxjerrë nga shtëpia dhe ka shkuar me këta të UNMIK-ut, gjegjësisht me forcat të cilat kanë qenë në vend, ka shkuar me ta që t'i nxjerrë njerëzit, që t'i shpëtojë, nuk e di. Ai ka alarmuar gjithçka të gjallë dhe më pas mua më kanë treguar që kjo ka qenë edhe në disa gazeta që ata kanë qenë të kidnapuar, çka po di. Mirëpo unë nuk kam ditur për këtë. Pra, unë, nga unë e kanë fshehur këtë. Madje edhe miqtë e mi më të afërt, ky Rasho dhe Vllado, Trbo e kanë ditur. Ata kanë ardhur tek unë çdo ditë dhe kështu në bisedë më kanë pyetur, "A janë lajmruar Mira edhe Rajko?" "Paj, jo. Pse?" "Po, vetëm ashtu pyetëm". Dhe një ditë u thashë, "Hej, u lajmruan, po vijnë!" Kishe paskan dalur. "Si?" Edhe vëllau im e ka ditur, përndryshe të gjithë kishin fshehur vetëm nga unë, kishe unë vetë nuk kisha ditë çka me ba. Mirëpo, ok, me gjasë pse kam qenë fëmijë e kanë fshehur nga unë.

[Tregimi vazhdon në pjesën e dytë]

Pjesa e dytë

Marijana Toma: E përmende "Pandën" më pas mikun tënd Draganin i cili ka vdekur dhe Vlladën i cili është lënduar.

Nikolla Jovanovic: I cili është lënduar, po.

[10] Jedan od četvorice braće Karić, poznatih biznismena iz Peći.

Marijana Toma: Ti i ke pasur 18 vjet kur kjo ka ndodhur. A të kujtohet edhe diçka tjetër?

Nikolla Jovanovic: 17 vjet, po, e mundshme që i kam mbushur 18. Ky është dhjetori i '98-tës, pra vetëm sa i kam mbushur 18. Më kujtohet, si nuk më kujtohet. Po mendoj, "Panda" ka qenë kafeneja jonë e preferuar, që nga viti i parë, ai është pranë gjimnazit, kafeneja. Të gjithë kemi shkuar aty, ai ishte vendi, *place to be* [Anglisht]. Dhe për Vitin e Ri shkon në një ndejë dhe së pari shkon në "Panda" për kafe më pas atje. Në mëngjes shkon sa më herët që të arrish ta pijsh kafën para orës së parë. Ashtu e hapë, e kemi ditur ku është çelësi, pronari, ky Suki na ka dhënë çelësin dhe ti ke shkuar ia ke rregulluar atij super. E kemi ndezur shporetin, i bëjmë gati të gjitha dhe ai kur të vije vetëm mund t'ia fillonte punën. Ne kemi shkuar aty gati, gati se çdo ditë. Pra ky ishte vendi ynë, ku ti e kalon pasditen, madje edhe kur nuk ke mësim e kalon pasditen aty dhe mbrëmjen, sepse këtu shikoheshin ndeshjet, këtu luhen letrat, luhen edhe *lorum*, *firz* e çka po di. Këtu ka hajgare, këtu është, po mendoj këtu kemi jetuar, ky ishte vendi ynë.

Dhe më pas, ksi atë ditë nuk kam shkuar. Kjo është ajo sociologjia të cilën e kam urryer nga thellësia e shpirtit që ma ka shpëtuar jetën, pasi që kam pasur njish dhe jam dashur ta përmirësoj para gjysëm-vjetorit dhe jam dashur… Themi, që atë profesoreshën shumë e kam urryer, sepse sociologjinë, ajo nuk e ka ligjeruar aq mirë. Unë sociologjinë më vonë e kam pëlqyer përmes punës, mirëpo kisha ndenjur në shtëpi për të mësuar. Dhe më kujtohet sikur dje që ishte, që kemi luajtur *Sony playstation*, nuk e di kemi folur nëse do të shkojmë apo jo. Almiri, ky Jasharoviqi, ai i cili thoshte, "500 vjet, 500 vjet keni qenë ndër ne". Ky Almiri, unë, Dragani dhe Dragani ka qenë këtu pak kohë dhe ka qenë Trbo dhe nuk di kush tjetër ka qenë. Jo, Trbo nuk ka qenë këtu, Trbo ka qenë te shtëpia e tij. Mandej kemi folur nëse do të shkojmë, nuk di, "Më duhet të mësojë, ndodh që vi më vonë". Kishe do të vijmë, kishe jo. Më kujtohet që kam qenë në shtëpi dhe u dëgjova me Trbon, "A po shkojmë a jo?" Por edhe ai duhej të mësonte, "Hajt dëgjohemi më vonë". Kjo ishte e tëra.

Më pas, po mendoj, dikush ka thirrë në shtëpi dhe ky i ka pyetur këta të familjes nëse jam aty. Nëna ashtu, "Po, qe po mëson". "Të lutem verifikoje nëse është në dhomë". Ajo i ka thënë, "Po". Ai i ka treguar, "Ka pasur masakër në 'Panda' nuk e dijmë çka ka ndodhur. E dijmë që ka pasur të shtëna dhe shumë prej tyre janë të lënduar". Dhe tash, unë, veç çka nuk dola nga lëkura ime. Unë në atë moment dhe në muajt në vijim jam ndier si tradhtar, bukfalisht. Pasi që çdo ditë kemi qenë së bashku, çdo ditë të njëjtën e kemi bërë së bashku, dhe unë përnjëheri nuk kam qenëêaty. Dhe kjo është… dhe kjo më ka përcjellur. Tash unë nga kjo perspektivë me siguri menjëherë kisha shkuar, kisha shkuar te dikush për të folur, të ndonjë profesionist, me ndonjë psikolog, psikiatër, por atëherë nuk [është praktikuar]. Atëherë pas një kohe, të familjes më dërguan në Çaçak te ky Lekica për disa ditë për ta kthjellur kokën. Mirëpo më kujtohet, që nuk e dija çfarë të bëj me vetën. Unë do të kisha shkuar tash sepse nuk e di kush kishte shkuar. Nuk kemi pasur telefona mobil, nuk e di. Unë do të vrapoja deri te shtëpia e Draganit, mirëpo nuk guxoj, sepse nuk kam shumë ide. Nuk kam asnji informacion, nuk di asgjë.

Dhe më pas filluan të arrijnë lajmet njëra pas tjetrës që kaq janë të vdekur, kaq të lënduar, që shpejt po ngiset, që një veturë shkoi me Svetën. Ai më pas në spital, në tavolinën e operacionit apo në veturë kishte vdekur, që Vllado Llonqar ishte i lënduar, i bërë shoshë nga plumat, që atij nuk i kanë dhënë asnjë shansë por ai ka mbijetuar në fund. Mendoj që atë mbi 15 pluma i kanë rënë apo kaluar nëpër të, i ka munguar një një pjesë kaq {tregon me duar} e ashtit, kështu që i ka bartur ato fiksueset për një kohë të gjatë, nuk di.

Po mendoj, më pas kemi dëgjuar kush krejt, dhe kjo ka qenë një shok. Pra, më kujtohet që kam qenë i ulur dhe kam shikuar në një pikë dhe asgjë, nuk kam pasur emocione, asgjë, vetëm zbrazëti. Dhe mendoj që unë për herë të parë kam qajtur dikur pas varrimit, po, po, po tek atëherë ia kam lëshuar, pasi që atëherë e kam kuptuar sepse deri në atë moment ka qenë ashtu. Po mendoj, krejt kjo ka qenë e organizume. Ne kemi qenë, po, përndryshe nuk ta tregova, kujdesi dhe këto varrime kanë qenë shumë mirë të organizuara, sepse në atë verë '98, disi çdo ditë dikush ka vdekur dhe çdo ditë është dashur dhe më pas ka pasur [tubime] përkujtimore dhe të gjitha, dhe po çdo ditë është dashur ndonjë ndihmë në varreza. Dhe ne kemi shkuar kështu varësisht kush dhe sa ka pasur kohë për të shërbyer, për të ndihmuar dhe shumë të kordinuar kemi qenë. Kështu më vonë kur ndodhën varrimet e prindërve të të afërmive kisha munguar sepse më nuk mund të shihja varreza me sy dhe as zakonet rreth krejt kësaj.

Tash i tëri ky organizim, më kujtohet që të gjithë mundoheshim të ishim të dobishëm dhe ndodh që edhe kjo na ka ndihmuar paksa. Besoj që po, të gjithë na thonin që ju tash duhet të jeni të urtë, duhet të ndihmoni, duheni të merreni me këtë dhe këtë, s'ka mendime të këqija, nuk ka ju të shkoni dhe të hakmerreni, nuk kam lidhje sepse ka pasur edhe ide të tilla. Por disi, po, na arritën lajmet që këta të tonët po kërkojnë krejt këto, përndjekje, çka po di. Dhe ka qenë, më kujtohet ky varrim me një numër të madh të njerëzve të cilët kishin ardhur nga të gjitha anët, i tëri ky varrim dhe i tëri ky disi, po mendoj, nuk kam lidhje gjithçka ka qenë në numër të madh, mirëpo kur gjithçka përfundon, atëherë të nesërmen mbesim ne, dhe nuk e di.

Më falni, vështirë është, nuk mundem shumë po thellohem në këtë. Shumë gjatë nuk kam menduar apo folur për këtë. Në ta mendoj, natyrisht i kujtoj sa herë shikoj fotografitë dhe çdo 14 dhjetor, edhepse nuk shkoj në kishë që një kohë të gjatë, atëherë shkoj, e ndezi një qiri për ta, mendoj në ta dhe të gjitha, por…. Po mendoj, ideja e tërë që ti përnjëheri, po mendoj në fakt atëherë ka përfunduar fëmijëria. Ai është momenti kur fëmijëria përfundon pasi që kjo, më nuk mundesh të mendosh për këtë, prej aty nuk ka dalje, ku do të shkojmë ne, shkolla, çfarë shkolle? Kush po mërzitet për shkollë?

Më kujtohen të gjitha, ky ishte gjysëm-vjetori i dytë, kjo nuk ka ekzistuar. Në fund unë kam adhuruar historinë, dhe kam shkruar punimin e maturës në histori te profesori im i preferuar. Ai njëjtë e ka adhuruar basketbollin dhe ka qenë *grobarčin*[11] i madh, andaj e kam adhuruar dhe kam shkruar diçka paraprakisht, një punim të madh për Napoleonin dhe kështu që unë tashm e kisha, mirëpo nuk jemi dashur. Në fund vetëm na i kanë ndarë ato diploma dhe kishe, "Hajde gëzuar!" Dhe më kujtohet sa pikllueshëm ka qenë kur u paraqitëm në shkollë për t'i marrë ato. Kishe, duhesh me qenë i lumtur që e ke përfunduar shkollën.

Ne në fund nuk e kemi pasur as mbrëmjen e maturës. E kemi pasur dikur krejt vonë, kur njëri nga gjenerata jonë, Raja, Nikolla Rajoviq, ai njëjtë ka qenë në "Panda" atëherë, edhepse ai ishte i lumtur, ai nuk ka qenë i lënduar. Atij vetëm i është kapur diçka për gishta, ai pasi që ka pasur mundësi, ai e organizoi për 18 vjetorin, kishe maturën pas 18 viteve. Dhe ai i ka organizuar të gjitha dhe ai tash e organizon çdo dy vite, ai i paguan të gjitha. Herën e parë kemi qenë në hotelin e tij në Velika Plana, mandej kemi qenë para disa viteve në Selanik. Ai i organizon të gjitha, autobusin, akomodimin, çdo gjë ai e paguan vetëm që ne të mblidhemi. Dhe atëherë bëhemi bashkë aq sa mundemi. Kjo me të vërtetë është një gjë e bukur dhe kjo është pak që na mundëson të jemi bashkë, nëse asgjë tjetër. Të gjitha gjeneratat tjera e kanë pasur një fund të shkollës kudo, kurdo herë, kanë pasur diçka. Vetëm ne kemi qenë ajo gjenerata e nemun e cila nuk ka pasur asnjigjë prej kësaj.

[11] Serb. *grobarčin,* varrëtar, është një term kolokial që i referohet tifozëve të klubit të Partizanit në Serbi.

Marijana Toma: Dhe tash pas "Pandës" nuk do të pyes më për këtë, por…

Nikolla Jovanovic: Më pyetni lirshëm, momenti është pak, por Ok. Mendoj që duhet të flitet për këtë.

Marijana Toma: Kjo është nga ato ngjarjet që nuk dihet shumë për to, dhe ka lloj-lloj tregimesh, dhe disi ajo qëndron e pasqaruar e patreguar dhe ky është një ndër krimet e para të cilët ndodhin në Kosovë. Cilat kanë qenë reagimet e para? Ke përmendur pak, natyrisht…

Nikolla Jovanovic: Po, tek ne nuk ka pasur dyshim që këtë e kanë bërë shqiptarët. Thjeshtë ata kishin qenë njerëz me maska. Shumë shpejt ka dalur ai informacion që ka qenë municion dhe kallashnikov kinez, sepse janë bllokuar. Këta që kanë mbijetuar na kanë treguar se ato janë bllokuar dhe nuk kanë arritur të shtiejnë në të gjithë, këta dy. Ne thjeshtë e kemi ditur që janë shqiptarë dhe kjo ishte e tëra. Nuk ka këtu, nuk e dinë as kush janë as çka janë. Supozohej që kjo ka ndodhur për shkak të ndodhive në Koshare dhe të gjithë kemi menduar që ishte ashtu. Dhe menjëherë policia është nisur në akcionin e madh në Kapeshnicë. Nuk e di, vinin informatat si e kanë arrestuar këtë apo atë, dhe thjeshtë nuk ka pasur ide tjetër që dikush tjetër ka mundur të jetë, që dikush nga anash ka mund ta bëjë këtë.

Dhe më pas, mua më kujtohet që vite më vonë unë kam qenë në Sutomore te, meqenëse atje jeton familja, prindërit dhe familja e të ndjerit Dragan, dhe u ktheva që t'i shoh. Mandej ajo, nëna e tij më ka treguar kur ata i kanë përjashtuar nga shtëpia, që kanë stopuar kur e kanë parë kush është, dhe kur e kanë parë, ata nuk i kanë keqtrajtuar, nuk i kanë rrahur në dalje mirëpo u kanë thënë, "Hajde dilni jashtë, mirëpo do të befasoheni kur ta kuptoni se kush ua ka vrarë djalin". Dhe ajo tash, ajo e kishte këtë informatë, ajo i kishte fyer ata, "Si mundesh ti mua…" ky është spin. Mirëpo kur ti tash vite më vonë e dëgjon që diçka e tillë, që mundësia ekziston që mund të ketë qenë DB [Sigurimi Shtetëror], unë tash kur e shikoj kështu, kur e shikoj, unë edhe tash nuk mund ta besoj këtë. Edhe tash nuk mund ta besoj që madje njerëzit më të këqij që ekzistojnë janë në mesin… të cilët shteti i Serbisë i ka organizuar që 'poshtë' në Kosovë të bëjnë shumëçka, unë ende nuk mund ta paramendoj që ata kanë sulmuar për të vrarë fëmijë. Po mendoj, mirë, hajde Ok e gjuajnë ndonjë bombë në qendër [të qytetit], nuk e di, që të bëjnë shoshë nga plumat nuk di çka, por fëmijët? Nuk e di, gjithçka është e mundshme natyrisht.

Unë do të doja që me të vërtetë, në fakt këtu më së shumti më iriton që kryeministri, tash është president, thotë që këtu ekziston mundësia, mirëpo ai nuk e din, nuk dihet dhe do të ishte tepër e madhe nëse publikohet. Unë mendoj që duhet të publikohet. Unë mendoj që as ai as askush nuk mund ta kuptoj sa shumë shqetësim i ka shkaktuar mjedisit tonë. Kur po them që kjo mua më ka shqetësuar, mund të paramendoj vetëm prindërit e viktimave sa shumë ata i ka shqetësuar, sepse po them, që në fund të fundit ata kanë vrarë fëmijë dhe kjo do të duhej të ishte relevante, mirëpo nuk është. Tash të kuptosh që shteti yt ta ka vrarë fëmiun, po kjo nuk e di, kjo është fundi i botës. Nuk e di çfarë të bëj me vetën.

Kështu që ka qenë tmerr, e them e tëra kjo, e tëra pas kësaj, sa më përket mua dhe miqëve të mi, kjo nuk është kaluar me mllef. Në neve, po mendoj, mllefi veç ka ekzistuar. Ti vetëm ke vërejtur që Ok, tash këta përnjëheri janë ndarë në dy anë, serbët kundër *šiptara* dhe kjo është kjo. Tash ne kinse po e mbrojmë tonën, ata kinse po i sulmojnë të tonët. Po mendoj, unë tash këtë të tonën dhe të tyren nuk e kuptoj. Në rregull të të sulmojë një amerikan, dhe të themi që kjo është e jona, ne jetojmë këtu. Kur ne të gjithë jetojmë këtu, e imja, NATO, e jona, nuk e di. Mirëpo Ok, unë them edhe sot që mua më vjen keq që atëherë, nuk, që nuk ka zgjatur disa vite dhe që gjeneratat e reja, ne të rinjtë, që ne të

bashkojmë forcat, serbë dhe shqiptarë kundër Beogradit, që të kërkojmë që Kosova të merr atë që i takon edhe autonominë ekonomike dhe të gjitha, investimet, nuk kam lidhje, sepse kjo është e vetmja që njerëzve iu përshtatet.
Po, sigurisht që kanë qenë, më kujtohet kur shkon për Prishtinë, shkon në Mitrovicë, dhe janë edhe ato fshatrat e ngritura për anash. Duket sikur fshatrat në Asteriks, Obeliks[12] muret e nalta e të gjitha këto. Këtu ke tregime të ndryshme, që nga këtu nuk del askush me vjet, që vetëm njëri del për furnizim dhe kthehet, po mendoj këto janë tregime të çmendura, mirëpo ka pasur bindje të tilla, ku besoj që ka pasur edukim ultra të ultë dhe që lehtë është atyre njerëzve me ua dhënë pushkën dhe t'u thuash, "Eh, po shkojmë ta pushtojmë sepse ata po na shtypin", nuk e di. Kur po e mendoj si shtypje, pasi që në fshat asgjë serbe për 50 vite nuk ka hyrë? Zakonet lokale, nuk ka këtu zakone të Kosovës, apo Serbisë apo të Jugosllavisë, nuk ka.

Mirëpo tash e them që njëfarë lloj mllefi ka ekzistuar edhe për shkak të "Pandës", por mendoj që nuk ka ekzistuar. Mendoj që ne shumë gjatë kemi qenë në gjendje shoku. Nuk ka mundur mua më askush asgjë, dhe ka pasur frikë për këtë. Ka pasur shumë frikë, sepse edhe mua më kujtohet kjo, sepse edhe unë e kam pasë këtë tmerr. Baba, nuk e di, tash ai do ta kuptojë nëse e shikon ndonjëherë, shpresoj që jo, unë në çantë, në janxhik e kam bartur armën e tij. Sepse në mbrëmje kur shkoja, jo gjatë ditës, mirëpo në mbrëmje e di që kur binte terri unë e bartja me veti sepse nuk e di. Thjeshtë më ka dhënë njëfarë sigurie, unë e mbaja këtu, nuk kishte pluma, nuk e di si. Kur mendoj tash, nuk e di si e kisha nxerrë atë armë, lidhje nuk kam, kanë mundur tre herë të më vrasin për këtë, mirëpo mua më ka dhënë siguri.

Tash kur po e kthej filmin, ti bre je fëmijë 17, 18 vjet, i cili bartë armë në janxhik dhe po shkon nëpër qytet? Tash vet ideja që unë jam në një mjedis të tillë dhe që më duhet ta bëjë këtë më jep tmerr. Po mendoj, tash unë, e vetmja gjë që ndoshta mund të them është t'i fajësoj prindërit e mi, edhepse Ok, as ata nuk kanë mundur apo ditur më mirë. Unë tash fëmiun tim kurrë nuk e kisha vënë në pozitën time. Pra, unë menjëherë e kisha paketuar atë dhe të gjithë dhe kisha shkuar, jo në Beograd, por jashtë vendit përgjithmonë. Thjeshtë nuk dua të gjendem në atë mjedis dhe tërë asaj. Mendoj, njëjtë shikuar nga kjo perspektivë, po mua më ka bërë më të fortë krejt kjo, po më ka bërë më të pavarur, me siguri edhë më normal. Edhe nuk e di, kur mua dikush m'i shpreh paragjykimet për këtë dhe ate. Paragjykime, po çfarë paragjykime ke ti? Ti je prej, nuk e di, atij fshatit pranë Kragujevcit dhe kurrë nuk ke parë njeri të huaj në jetë, e ti ki paragjykime për gjermanët, turqit, shqiptarët, amerikanët. Çfarë paragjykime o njeri, nuk ke pa asnjigjë, ashtu ke qenë në deti diku edhe kjo është e tëra.

Tash mua kjo me të vërtetë më dhemb, mirëpo nuk kisha [bërë] kurrë [këtë] në jetë fëmiut tim dhe poqëse e kisha parë që diçka po shkon keq, që ekziston mundësia për diçka ashtu, biletat e aeroplanit dhe *Ciao*! Një kofer dhe nuk më intereson, po mendoj nuk di. Nuk do të lejoja kurrë që fëmiu im të rritej ashtu, më mirë të jetë amerikan i lazdruar apo gjerman i cili lidhje nuk ka, se sa të përjeton atë që jam dashur unë ta përjetoj.

Marijana Toma: Tregove më herët rreth bombardimeve dhe si është dukur, e pushkat etj. A të kujtohet diçka tjetër e shkuar, diçka para kësaj? The që baba yt e ka murosur shtëpinë dhe që ka jetuar me bindjen që nuk do të ndodh. Mua më…

Nikolla Jovanovic: Po, ai e ka murosur shtëpinë sa kanë qenë bombardimet. Ai tërë kohën e ka murosur shtëpinë. Ne jemi qeshur me të, i çmendur! Sepse ai, "Po kjo do të kalojë, Pejën nuk e

[12] Francuski strip o starim Galima.

sulmojnë.” Një herë është dëgjuar sirena, në fillim dhe në fund të bombardimeve, sepse gjatë gjithë kohës kanë fluturuar nga Avijano mbi Pejën, kështu që nuk kemi pasur arsye për të ikur në podrum, nuk di, kjo është e tëra. Më kujtohet që e vetmja që na ka munguar atëherë ka qenë duhani. Eh po tash, dëgjon që aty afër Brzhenikut ka duhan. Dhe më pas shkon me biciklete atje dhe më kujtohet që kam shkuar. Tash mëtanë rrugës së Brzhenikut është ajo kazerma e madhe e Pejës, të cilën e kanë bombarduar, nuk e di sa herë, dhe më kujtohet që unë kam kaluar dhe hyrë në shtëpi të një shoqës kur e kanë gjuajtur. Gjithçka është lëkundur, bukfalisht aty ku kam kaluar. Dhe kjo ka qenë, “Ok, ndoshta isha dashur të kam më shumë kujdes”. Mirëpo para kësaj nuk ka pasur diçka serioze.

Hajde para bombardimeve ka pasur tregime të ndryshme, pasi që këtu kanë qenë mbikëqyrësit ndërkombëtar në Kosovë, nuk e di si quheshin, nëse UN apo ashtu diçka, nuk e di por më kujtohet që ata, unë atëherë lëvizja me makinë, orët e para të vozitjes. Unë gjithnjë kam… u kam thënë atyre që jam baksuz pasi që kur fillova vozitjen nisën bombardimet, herën e dytë kur fillova orët e vozitjes në Beograd, kjo shkolla u mbyll dhe për një kohë nuk kam dashur pasi që isha baksuz. Më kujtohet që atëherë kur fillova, që instruktori im më tha, “Dhashtë Zoti të përfundoj kjo në shpejtësi”. Kishe shumëçka mund të ndodh. I tha njëri që jetonte me të në shtëpi, me gjasë ky ia ka dhënë me qira banesën, kishe diçka do të ndodh dhe ata duhet të largohen, që do të thotë diçka do të fillojë.

Thashë, “Mirë, ok, s’ke çka”. Dhe ne nuk e kemi pasur atë… ka pasur tregime që nuk do të ketë dhe nëse do të ketë diçka, çka mund të ketë? A janë bombat, a janë invazionet, a është ndonjë lloj lufte? Nuk ke pasur shumë ide se çfarë lloj i intervenimit, por diçka do të ketë. As tash, unë tash që i kam përjetuar bombardimet, tash mund ta di dhe të them që kanë qenë të mëdha apo të vogla mirëpo atëherë, nuk ke ide çka janë ato, dhe çfarë bomba janë ato, nuk di. Më kujtohet që kemi ndenjur pas darkës, natyrisht të gjithë e dijmë momentin kur ka filluar, ku kemi qenë, çka kemi bërë, dhe më kujtohet që nana dhe baba shikonin njifarë seriali të trashë, njëfarë, s’e di a ka qenë turke, spanjolle, ku ta di, njëra prej atyre dramave televizive. Dhe, më kujtohet që ai shoku im Vllado Vuqinic kërsiti me njëfarë kaishi prej rrypi, kinse po shkon në luftë, “Bombardimet, hajde po shkojmë në podrum”, I them, “Çka?” Dhe më pas filluan me sahat dhe ia nisi. Mendoj që në Pejë nuk ka ndodhur shumë atë natë, në princip asgjë. Baba tha, “Nëse dëshiron me dalë para ndërtesës, dil. Nuk do t’i gjuajnë ndërtesat sigurt”. Dhe tani ka qenë njifarë ngazëllimi, ka qenë diçka, po ndodh diçka, dhe më pas kur filloi mandej ka pasur gjithçka.

Në ditët e para ka qenë pak situatë e pakandshme sepse kanë gjuajtur atë radarin në Karagaç në qendër të qytetit, kanë gjuajtur këtu kazermën mirëpo përtej kësaj nuk ka pasur asgjë speciale. Po, kanë gjuajtur mbi kodrat përreth Pejës, pasi që aty kanë qenë bunkerët e vjetër nga Lufta e Parë, Dytë, dhe këtu kanë menduar që ka diçka dhe e kanë gjuajtur, çka po di. Dhe kjo ishte kjo. Perveç kësaj ka qenë kryesisht qetë në qytetin tim. Për neve sinqerisht ka qenë problem serioz këta dezerterët. Pasi që ka pasë dezerterë të ndryshëm të cilët vinin, që fsheheshin këtu, po fsheheshin. Nuk ishin dezerterë, nuk e di, fëmijë të mirë të mamit dhe babit, por ishin dezerterë të cilët kush e di ku kanë vjedhur të holla, dhe tash ka ardhur dhe kanë hapur lokal dhe nuk e di çka bëjnë këtu. Dhe më shumë na bënin probleme këta sepse nuk e dije çfarë mund të ndodh dhe me kë mund të ndeshesh.

Disi ndryshoi qyteti, shumë njerëz kishin shkuar nga qyteti. Pasi që tash, këtu fillova të kuptojë që Peja ka pasur shumë malazezë. Deri atëherë kemi qenë thjeshtë ne. Shumë prej tyre kishin shkuar për, për, për Mal të Zi te të vetit. Ne të cilët qëndruam, paj, në princip ka qenë shumë mërzitshëm. Nuk ke pasur çfarë të bësh, shpesh nuk ka pasë rrymë, ndonjëherë nuk ka pasur as ujë me ditë të tëra, kryesisht telefonat nuk kanë punuar absolutisht. Ashtu, kemi komunikuar atëherë kur jemi takuar, i kemi pasur disa pika ku jemi takuar, jemi mbledhur nëpër shtëpia, të llojit nuk e di, shoku nga soliteri, shqiptarët

të cilët kishin shkuar dhe atyre ua kishin dhënë çelësat dhe ne në shtëpi bënim jetë aty dhe shoqëroheshim. Dhe po, ata kanë pasur një televizion të madh, dhe kemi marrë kaseta dhe shikonim filma dhe çka po di.

Përafërsisht, po mendoj, jeta jonë ka qenë a do të gjejmë duhan për të blerë dhe kjo ishte. Nuk ka, mërzitshëm ka qenë, tmerr. Njëmend ka qenë ultra mërzitshëm, nuk kemi pasur ne tregime se kur do të niset. Po, natyrisht ka pasur tregime, këtu kanë gjuajtur këtë apo atë. Ka qenë kohë pas kohe. Po, meqenëse ka pasur ato masat e paramilitarëve, në princip "Munja Pejane"[13] dhe ata të "Legijes", çka po di. Kohë pas kohe ata vinin në qytet, dhe shkonin nga qyteti, ajo ka qenë, i ke shikuar dhe lidhje nuk ke pasur kush është a çka janë. Ndonjëherë kalonte ndonjë ushtri, ndonjëherë jo, po mendoj mërzitshëm. Eh pra, një pjesë të mirë të ditës ke fjetur pasi që natën ke mabjtur atë kujdestarinë e çmendur. E kjo ishte diçka që me të vërtetë… për najfarë arsye birraria e Pejës ende punonte. Tash nuk e di, a ka punuar me kapacitet të plotë, mirëpo më kujtohet që në 6:00 në mëngjes kalonte cisterna, dhe cisterna ndalej e mbushte atë birrën e pasterilizuar në ato gallonat, dhe ne më pas i bartnim në shtëpi. Ajo është birra më e mirë që mund të ekzistoj, për shembull nga cisterna, e ngrirë e krejt kjo. Këto janë disa detaje.

Kjo pjesa tjetër e tregimit, ai pikëllimi. Mua më kujtohet që kjo, kur filloi, më kujtohen edhe kolonat. Ajo, kjo është ajo që ka lënë gjurmë për të cilën mendoj dhe nuk më pëlqen shumë t'i kthehem sepse është bash fort, bash emocionale. Më kujtohen miqtë tanë nga fqinjësia të cilët i shihje në kolonë dhe e dije që nuk guxon të vraposh pas tyre t'i përqafosh dhe nuk guxon t'i përshëndetësh pasi që këta "tonët" të cilët e ruanin kolonën do të mund të të goditin, Zot mos e bëj që të gjuaj me armë, nuk di. Po mendoj, nuk do të gjuanin në një fëmijë, mirëpo ku ta di. Dhe ti tash qëndron, shikon si dikush me të cilin je rritur ecën në kolonë, o njeri. Po mendoj, tmerr, çka tash? Tash ty të vijnë disa informata që vetëm një pjesë e tyre po shkojnë, që kanë organizuar autobus për ta, që ata po shkojnë, nuk di, tani kemi marrë informatën që ata vetë kanë vendosur të shkojnë, nuk e di. Unë nuk e di, ai që thotë, po, edhe sot që mendon nga ata që e kanë parë atë kolonë në atë moment që nuk e ka ditur që ata nuk po shkojnë me vullnetin e tyre, të mos e gënjejnë vetën. Po, disa nuk kanë dashur të qëndrojnë, sepse e kanë ditur çka mund t'iu ndodh, por po mendoj, të mos e gënjejmë vetën, nuk kanë shkuar me vullnetin e tyre.

Ka pasur këtu tregime, nuk e di, afër nesh aty te "Bananja" ai ka qenë një dyqan i madh, e tërë kompania është quajtur "Bananja" që këtu te "Bananja" njëri, një gjysh ka dalur dhe ka thënë, "Unë nuk mund të shkoj", dhe ata e kanë vrarë aty për aty dhe ia kanë lënë trupin të qëndrojë aty. Unë këtë nuk e kam parë, mirëpo këto janë ato tregimet të cilat më kujtohen, të cilat janë të tmerrshme. Ishte këtu, dhe arsyeja pse nuk kemi guxuar t'iu afrohemi, sepse ka pasur tregime që këta tonët janë afruar t'u japin boca me ujë, dhe këta tonët i kanë rrahur me shufra gome, çka po di, "Atyre ua kemi organizuar të gjitha, çka po u afroheni?"

Këto janë gjëra shumë të tmerrshme të cilat nuk kisha dashur askujt t'i ndodhin, sepse po them, mua absolutisht nuk më intereson kush e filloi, absolutisht nuk më intereson kush është krahu i ligë këtu, absolutisht nuk më intereson kush ka të drejtë, nëse duhet, nëse Kosova duhet të jetë e pavarur apo

[13] *Munje* kanë qenë njësi lokale policore e cila ka operuar në Pejë dhe rrethinë, pranë MUP (Ministrisë së Punëve të Brendshme) të Serbisë. Pjesë e këtij njësiti ka qenë *Šakali* [Shakalli], edhe pse sot nuk ka pajtueshmëri nëse *Šakali* kanë operuar në kuadër të njësitit *Munja*. Komandant i këtij njësiti ka qenë deri në vdekjen e tij Vitomir Šalipur. Ky njësit është përgjegjës për masakrat mbi civilët shqiptar në fshatin Qyshk në maj, 1999. Burimi: *War Crimes in Kosovo* [Krimet e luftës në Kosovë], Human Rights Watch, 2001.

jo, do të thotë është absolutisht irelevante. Ata mua dhe miqëve të mi, familjes time dhe të gjithëve, do të thotë njerëzve tëêmjedisit tim ua kanë shkatërruar fëmijërinë, pra ma kanë shkatërruar një pjesë të bukur të jetës.

Pra, te unë, veçanërisht në Pejë, unë me të vërtetë nuk e di kush nga Peja, nga ata shqiptarë nga Peja ka mundur të dëshirojë luftë apo diçka tjetër. Pasi që e tërë ekonomija është në duart e tyre. Të gjithë, nuk e di, e gjithë tregtia, të tërën e mbajnë shqiptarët. Kush mërzitet që ata [politikanët] ndërrojnë diçka këtu? Çka kanë me ndrru? Të gjithë ndërtojnë shtëpia, pesëkatëshe çka po di, po mendoj budallakina. Dhe tani duhet, të presësh sot prej teje që ti të lejosh një… që t'i të shprehësh qëndrim karshi asaj se Kosova është e pavarur apo jo. Mendoj që kjo është çështje aq irelevante, irelevante. Pra ajo çka mua më intereson tash është që tash kur baba im shkon në Pejë, ka filluar para disa viteve të shkojë disa herë në vit në një Shoqatë të Pejanëve, nuk di. Mua më intereson që ai të jetë i sigurtë atje 'poshtë', që ai të mund të shkojë te "Buçuku" në çebapa, të mund të shkojë në pazar, dhe të mund ta takojë njërin nga i cili kemi blerë djathë tërë jetën, edhe kajmakun e Rugovës, dhe nuk di, që ai të mund të shkojë në këmbë deri në Patriarshi dhe të kthehet.

Pra mua nuk më intereson, me të vërtetë nuk më intereson, unë jam plotësisht i hapur, për mua është gjë e çmendur që dikush në shek. XXI ndërton komb. Po mendoj, kombi si koncept përgjithësisht, kufijtë si koncept. Për mua është e çmendur plotësisht, pra unë mund ta kuptojë që ti dëshiron më shumë, dëshiron më shumë të drejta, dëshiron jetë më të mirë, i dëshiron të gjitha këto dhe mund ta kuptojë që një shumësi e njerëzve të paedukuar nga të dyja anët mund të përfitojnë në tërë këtë tregim, por të keshë njerëz të cilët edhe në ditët e sotme nga të dyja anët mendojnë në atë formë të, kush ka ardh këtu i pari? Apo e kujt është krejt kjo? Nuk e di, apo kush para treqind vjetëve, a ka qenë kjo xhami apo kishë apo ka qenë kishë tani xhami? Apo që, që apo që jeta me qenë e orientume kah nacionaliteti, besimi që e ke dhe idealisht je i lidhur me të dyja. Unë këtë nuk mundem, me të vërtetë nuk mundem të kuptoj. Mua aq ma vret mendjen sa që ndonjëherë nuk e shoh kuptimin e jetës në këtë regjion. Ku është kjo kaq e rëndësishme, aq sa duhet të përfolet nëse sot je i sigurt të shkosh në Prishtinë apo nëse është e sigurt për ta të vijnë në Beograd?

Neve shpesh na vijnë miqtë nga Beogradi, kur shkojnë për ndonjë vizë dhe vijnë t'i shohin prindërit, disa janë shqiptarë, disa turq, nuk është me rëndësi ata jetojnë në Pejë. Dhe tash i tërë ky koncept, kjo do të merr shumë kohë. Mirëpo tash, po, nesër Vuciqi do të del dhe të thotë që Kosova është e pavarur, por ai konflikt edhe tutje do të zgjatë sepse nuk ka vullnet për pajtim, ashtu siç kemi tregime ende rreth asaj nëse Srebrenica është gjenocid apo masakër, nëse janë tetë mijë, apo tre mijë njerëz? Mendoj që këto janë biseda të çmendura në këtë regjion që mua vërtetë ma vret mendjen, nuk është që kam nevojë të bashkohemi sepse jemi Jugosllav, jo. Unë jam për ta shkatërruar atë koncept të kombit, dhe absolutisht, jo [t'i themi] besimit, religjioni të largohet nga jeta publike që ajo të jetë çështje individuale, që të mos mund të ketë ndikim në askend. Dhe kur e them, po, kush m përcjellë në internet e di mirë që jam kritik i SPC-së[14] dhe i të gjithave, mirëpo këtu njëmend mendoj i të gjithave, të gjitha besimet, religjionet, të gjitha këto.

Këto koncepte në shek. XXI për mua janë të pabesueshme, nevrikosem kur flas për këtë. Me gjasë për shkak se kjo është, unë mendoj që kjo është, këto koncepte janë arsyeja pse unë nuk kam shtëpi në Pejë, në të cilën baba im ka ndërtuar gjithçka që ai ka që prej gjithëmonë. Kjo është arsyeja pse unë nuk kam qenë 'poshtë' aq gjatë, dhe pse në fund bre nuk i kam të gjithë ata shokë me të cilët jam rritur. Po mendoj tash po ndjekemi në Facebook, ashtu po gjindemi, po e kompenzojmë, mirëpo me

[14] Serb. *Srpska pravoslavna crkva* - Kisha ortodokse Srbe.

muaj qetësi. Ne po kompenzojmë, po i bëjmë lajka fotografive të njëri-tjetrit, mirëpo nuk flasim. Unë tash, pasi që, unë tash shikoj nga kandi im, nuk e di si ti adresohem, nuk e di në cilën gjuhë t'i flas, nuk e di nëse njeriu ende flet serbisht, kanë kaluar 20 vjet. Nuk e di çfarë t'i them. Nuk e di tash do të mblidhemi, dhe ngadalë, ngadalë do të takohemi dhe do ta dijmë si të flasim.

Mirëpo, unë këtë nuk, në fakt kjo ma ka vrarë mendjen që unë nuk e kam zgjedhur këtë, por këtë ka zgjedhur dikush ta vlerësojë që 'poshtë' duhet të luftohet dhe që duhet… që shqiptarët janë të ligë, apo në mesin e shqiptarëve serbët janë të ligë, jo Sloba Millosheviqi por serbët duhet ata t'i shpërngulin. Po mendoj, nuk di. Për këtë më herët kam qenë shumë agresiv në këtë komunikim rreth shprehjes së këtyre qëndrimeve dhe një numër i madh i pejanëve kanë hequr dorë nga unë, dhe kjo sot nuk bëhet përmes politikës por ata ta bëjnë *unfriend* [heqin miqësinë] nga Facebooku, shumë prej tyre mendojnë që unë jam liberal, tradhtar i popullit serb e të tjera. Mirëpo përgjithësisht këta janë njerëz të cilët e lidhin besimin me kombin, kishe ky është identiteti i tyre, pjesë e rëndësishme e identitetit tyre, gjë që unë gjeneralisht nuk e kundërshtoj. Ok, jam kundër kombit dhe religjionit, mirëpo nuk e kundërshtoj që kjo është pjesë e identitetit të dikujt, por që kjo të jetë pjesë e imja, kjo është e çmendur. Shiko bre sa shumë botë ke o njeri, një jetë ke, e ti po merresh me atë se kush ka ardhur i pari në Kosovë, kush po ia vë veshin? Shko në Tajlandë hulumto pak.

Marijana Toma: Prapë do të të kthej, tash përmende identitetin. Një ngjarje e rëndësishme në jetën e secilit njeri lidhur me identitetin, ti e përmende kur, largimi yt nga Kosova kur prindërit tuaj të dërgojnë në Beograd, por ti kthehesh. Ky është qershori i vitit '99.

Nikolla Jovanovic: Po.

Marijana Toma: Si dukej Beogradi për ty? Çka përfaqëson ti në atë moment në Beograd?

Nikolla Jovanovic: Eh, çfarë jam unë? Turist ende. Unë kam ardhur ta regjistroj fakultetin dhe të kthehem.

Marijana Toma: Më fal, cilin fakultet ke regjistruar?

Nikola Jovanović: Në fund kam regjistruar Tregtinë dhe Banka në BK[15] pasi që kam dashur, kam dashur FON[16], kam dashur Shkenca Politike. Kam dashur paralelisht gazetarinë dhe këtë, FON, dhe përgjatë FON edhe IT. Edhe në njërën edhe tjetrën më kanë thënë që duhet të regjistrohem në Prishtinë, që ka ardhur nga lartë urdhëri që nuk guxojnë të më pranojnë. Unë kam qenë në konsultime në shërbimin për studentët, "Unë do të studioj…" "Jo, jo, jo, na ka ardhur urdhëri nga lartë që askush nga Kosova nuk mund të regjistrohet".

Dhe unë kam qëndruar një kohë dhe më pas kam regjistruar Fakultetin pë Tregti dhe Banka, thjeshtë sepse ka qenë fakulteti i Kariqëve, ai fakultet bukfalisht është konceptuar në shtëpinë time sepse ai fakultet është dashur të jetë në Pejë, mandej filloi ajo në Kosovë dhe ata e kanë bartur në Beograd së bashku me fakultetin e menaxhmentit. Dhe tash dekanja, e cila ashtu miqësisht, po mendoj ajo ka qenë te na në banesë, ka qenë në Pejë disa herë, i tërë shërbimi i studentëve me pejanë, edhe hajde po e regjistroj këtë. Bankat jo që nuk më kanë interesuar në jetë, por kurrë as nuk e kam përfunduar atë fakultet, mirëpo e kam regjistruar. Ai fakultet më ka dhënë diçka më mirë. Më ka dhënë mundësinë

[15] Serb. *Univerzitet Braća Karić* - Univerziteti Vëllezërit Kariq.
[16] Serb. *Fakultet Organizacionih Nauka* - Fakulteti i Shkencave Organizative.

të bëhem pjesë e *AIESEC*[17], asaj organizatës studentore e cila m'i ka hapur horizontet, dhe u ka dhënë fund atyre paragjykimeve të cilat kam menduar që nuk i kam, e cila më ka mundësuar të gjithë miqët më të mirë, madje edhe gruan që e kam sot dhe të gjitha. Dhe jam shumë i kënaqur me zgjedhjen time atëherë, sepse me pasë qenë në FON, kishte qenë pikëpytje nëse do të isha anëtarësuar. Ata kanë pasur më shumë nga këto organizatat studentore dhe nuk besoj që isha antarësuar kështu siç kam qenë këtu.

Eh tash për mua ka qenë konfuze, e din. Unë veç kam qenë për një javë ditë dhe unë tërë kohën e kam kaluar me Vllado Lonqareviqin, me atë që ka qenë i lënduar, kështu që kemi shkuar çdo ditë në banjë, që të shërohet me rryma, që t'i gjallërohen nervat e dorës, pasi që ka pasur fiksatorë dhe të gjitha këto. Kështu që, unë kam kaluar kohë me të dhe kemi qenë fqinjë, mjaft afër kemi jetuar në Beogradin e Ri, unë bash te komuna, të dytë këtu, ai këtu te fontana, unë te komuna. Mandej kemi shkuar me 78-shin, këtë e kujtoj, "Shkojmë në banjë të pjekemi në rrymë", zezateshim. Mandej ktheheshim dhe kështu e kam përjetuar këtë me të deri në operacionin të cilin ai është dashur t'i nënshtrohet, nxerrjen e plumbit, nuk e di, gjithçka, po mendoj tmerr.

Pranë kësaj më kujtohet që kam humbur njëherë. Tash kjo Brigada Rinore 2, ndërtesa te rrethi, po shikoj prej dritares ku duhet të shkoj, deri te Mcdonalds dhe dal nga ndërtesa dhe shkoj në drejtimin e kundërt që për mua ka qenë vështirë dhe më është dashur kohë të mësohem. Më është dashur të fillojë të punoj menjëherë. Unë kam regjistruar atë fakultet, thjeshtë dhe nuk kam pasur ndonjë dëshirë rreth stilit të jetës, thjeshtë më janë dashur të hollat se prindërit nuk e kanë përballuar financiarisht.

Baba erdhi, nuk ka dashur të imponohet. Po mendoj Kariqët atëherë kanë ndihmuar një numër të madh të njerëzve të cilët kanë punuar për ta, dhe atyre që nuk kanë punuar për ta, shokë, ata janë munduar t'i punësojnë kudo që kanë mundur vetëm t'u ndihmojnë. Tash baba nuk ka dashur të imponohet, edhepse ai ka qenë një prej njerëzve më të rëndësishëm atje 'poshtë'. Ai dikur e gjeti një punë, nuk ka qenë ndonjë pozitë e lartë, mirëpo një punë me të cilën ka qenë i kënaqur, ka pasur rrogë, e të tjerë. Nana natyrisht nuk ka punuar, ka ndenjur në shtëpi, edhe ajo ka pasur oferta në këto laboratoret por ajo thjeshtë nuk ka qenë për asgjë pas kidnapimit dhe të gjitha atyre, kështu që ajo ka ndenjur në shtëpi dhe unë jam dashur të punoj. Dhe kjo ka qenë njejtë tek Kariqët në studion e dizajnit, që për mua ka qenë atëherë *dream job* [puna e ëndërrave], sepse kam ëndërruar të merrem me dizajn. Atje më shumë isha pengesë, të kuptohemi kam bërë disa power point prezantime, disa budallaki, dhe kjo është për një kohë.

Më pas e kam lëshuar punën dhe më pas kam qenë madje në qeverinë e Gjingjiqit[18] në Agjencinë për Siguri Shtetërore, më i vogël se ai që merret me kuverta, kam bartur letër, mirëpo atëhere drejtoresha Sonjica Bruno ajo vërejti diçka në mua dhe ajo pak më ka mentoruar dhe më ka udhëzuar si të zhvillohem, këte-ate, dhe sot e kësaj dite i falenderohem për këtë. Dhe tash këtu isha paralelisht me fakultetin, puna dhe *AIESEC* nuk bën. Unë për fat kam zgjedhur *AIESEC* dhe punën, dhe me të dyja jam marrë aktivisht, madje *full time* [tërë kohën]. Puna në agjension, agjencinë e kam braktisur kur punonim në atë kongresin e madh ndërkombëtar në Serbi. Dhe për mua ka qenë mjaft vështirë pasi që unë kurrë nuk kam qenë i rekrutuar, sepse ashtu më kanë humbur…

---

[17] *Association Internationale des Étudiants en Sciences Économiques et Commerciales* [Asociacioni Ndërkombëtar i Stundentëve të Shkencave Ekonomike]. *AIESEC* më nuk përdoret si akronim, mirëpo vetëm si emër i organizatës.

[18] Zoran Đinđić, kryeministri i parë i zgjedhur në mënyrë demokratike në Republikën e Serbisë, viti 2001-2003.

Dhe më kujtohet si ka ndodhur në Pejë, që ata vijnë në shkollë, dhe kush nuk është rekrutuar, të lajmrohemi vetë, "Të shkoni nesër në kazermë!" dhe unë kam shkuar në ndërkohë ka qenë e shtunë, dhe po ta gjeja sot atë ushtar i cili ka qenë te dera i cili më ka thënë, "Eh, e shtunë është nuk ka njeri. Mirëpo, më dëgjo do të më falenderohesh. Mos eja më këtu! A je çmendur? Ik nga ushtria!". Dhe unë kurrë nuk jam paraqitur më dhe më vjen keq që nuk ia kam marrë emrin dhe mbiemrin që ta gjejë dhe ta qarosi.

Për mua ka qenë problem i madh nuk kam mundur ta nxerri pasaportën, atëherë duhej dokumenti nga ushtria për pasaport dhe nuk kam mundur të udhëtoj. E mira e *AIESEC*, është që me *AIESEC* mund të udhëtosh botën me pare të vogla. Ke akomodim në çdo vend, shpenzimet e udhëtimit dhe gjithçka e gjallë. Në një moment arrita të shkoj në Kanadë, nuk është me rëndësi, dhe më pas e kemi organizuar kongresin e madh në Beograd i cili për mua ka qenë punë *full time* [me orar të plotë]. Kemi punuar madje edhe pa të holla, mirëpo e kemi pasur të premtuar një si rrogë sepse kishte buxhet të madh.

Dhe më pas kam qenë në konferenca të qyteteve dhe komunave, kam filluar nga poshtë, kam nxerrë letra nga printeri, kam mbajtur rrjetin e IT-së, madje kam themeluar departamentin e tyre. Grupet punuese për drejtorinë e IT-ve në komuna dhe qytete dhe kështu filloi të më rritej kariera, mirëpo e kuptova që nuk dua të merrem me këtë dhe kam shkuar në një punë praktike përmes *AIESEC*, që në fakt ka qenë punë *full time* në Stamboll në Mikrosoft, zyrja në Lindje të Mesme dhe Afrikë, ku jam marrë me punësimin shoqërisht të përgjegjshëm, me CRS-në[19], normal me tërë atë regjion prej Pakistanit deri në Afrikën Jugore, një pozitë fantastike.

Dhe mandej, unë budalla u ktheva mbrapa, në shtëpi, madje kam insistuar të kthehem dhe drejtoresha nuk më lejoi dhe madje unë kam shpikur, këtë më duhet t'ia sqaroj ndonjëherë, t'ia pranoj të vërtetën, unë kam shpikur që më duhet ta bëj një operacion të këmbës për t'u kthyer në Serbi, sepse ajo nuk lejonte. Ajo madje dëshironte të ma paguante, edhepse ajo e dinte që unë nuk kam fakultet dhe më duhej edhe një vit përvojë që të pranohesha për menaxher, që të mund të ma paguaj *executive master*[20] në London School of Economics në Londër për CRS. Dhe unë e dija që kjo është mirë, mirëpo do të ketë mundësi tjera. Dhe u ktheva në Beograd të themeloj një OJQ që merret me punësimin shoqërisht të përgjegjshëm dhe këtu u ndesha me një mur të tonin në sektorin e OJQ-ve. Nuk e kam ditur që duhesh të njohësh njerëz për të marrë ndonjë pare, pa marrë parasysh çfare është projekti.

Pra refuzova edhe një pozitë, njëjtë budallë në Kaliforni në *Hewlett-Packard* dhe më pas përfundova në resurset njerëzore gjë me të cilën edhe sot mirrem. Kam qenë në ERSTE Bank lokale, mandej në ERSTE Grupin, në univerzitetin e tyre korporativ dhe ja qe pesë vite jam këshilltar, merrem me mediat dixhitale, resurset njerëzore, zhvillimin organizativ, organizimin e kulturës dhe me gjëra të tilla. Mirëpo prapë them, çështja reale është, poqëse nuk kisha ardhur në atë mënyrë dhe poqëse nuk e kam regjistruar fakultetin në atë mënyrë dhe inkuadruar në *AIESEC,* a do të ishte kariera ime e tillë dhe jeta, me të cilën jam shumë i kënaqur? Mirëpo, nuk do të doja të përsëritem me ato detajet nga fëmijëria.

Marijana Toma: Mua më intereson edhe prindërit e tu, kur ata vijnë në Beograd?

---

[19] Ang. *Corporate-social responsibility* - Përgjegjësia Shoqërore Korporative.

[20] Studime të magjistraturës për profesionistë me rangim të mesëm apo të lartë me pozitë, zakonisht e lidhur me administratë apo menaxhment.

Nikolla Jovanovic: Po ata kanë ardhur dhjetë ditë pas nënshkrimit të paqes. Pra ata qëndruan, ua kemi dërguar të parën, dytën ditë, ua kemi dërguar veturën 'poshtë'. E dërguam njërën veturë përmes një shoku, e mbushëm dhe njëri nga shokët e kanë vozitur. Dhe atyre u ka konvenuar pasi që kanë pasur më shumë vend në veturën e tyre të paketojnë më shumë gjëra. Kanë paketuar fotografi, disa kofera me garderobë dhe këto, dhe ata qëndruan me qëllim që të mbesin. Nëna ka qenë më e vetëdijshme me idenë, "Hajde po shkojmë", ndërsa baba, ashtu, "Ku të shkojmë ne? Kjo është e jona, e imja, unë kam lindur këtu. Baba im ka lindur këtu, gjyshi. Si bre të shkoj unë nga këtu?" Sikur t'i kishte pasur 80 vjet, e jo… Baba ka qenë pak i verbuar, ka shikuar gjithçka përmes syzave rozë dhe më pas ndodhi çka ndodhi dhe më pas erdhën pas tre ditë. Po mendoj, ata kanë qenë të burgosur, nuk di ndryshe si ta quaj, pesë, gjashtë ditë, nuk jam i sigurt sakt sa. Dhe ata thjeshtë janë ulur në *pick-up* dhe erdhën në Beograd.

Marijana Toma: Çka ka ndodhur me pronën?

Nikolla Jovanovic: Me pronën? Po, baba arriti t'i shesë të gjitha në fund. Tash kjo është… në banesë ka hyrë një, një nga fqinjtë tonë të parë me të cilët jam rritur. Po, këtu janë disa tregime interesante. Të mos ta detajizoj, por atë [babën] më të vjetrin e patën arrestuar dhe tek ai patën gjetur një listë. Atëherë ashtu ka qenë e organizuar derisa nuk ka dalë publikisht UÇK-ja, ata ashtu kanë funkcionuar nëpër qelija dhe kudo. Te ai patën gjetur listën, ai u arrestua dhe edhe baba ka shkuar ta nxerrë nga policia sepse kishe s'ka kuptim është fqinji ynë, "Mos ma arrestoni fqiun, a jeni normal?" Atëherë baba i ka përdorur të gjitha lidhjet dhe ata i kanë thanë babës, "Nuk ka problem do ta lirojmë, por ai duhet të zhduket nga qyteti". Kishe tek ai kanë gjetur listën ku ishim ne në listë për likvidim në rast se do të vie deri te lufta. Bukfalisht, ai është dashur të na vriste. Tash ai nuk ka qenë me atë mendësi, e di, jemi rritur bashkë, nuk ka këtu çka. Mirëpo ai e ka pasur listën. Dhe pas kësaj ai u zhduk, thjeshtë ka shkuar, është tërhequr, kudo që… veç ka qenë ai.

Djali i tij Ramizi të cilin unë e adhuroj i cili ka qenë model për mua në fëmijëri. Ashtu, i gjatë, i fortë, i madh, i mençur, ai na ka organizuar, nuk e di, një karakter super. Ai ka qenë një, madje komandant i lartë në UÇK, nuk e di. Pas luftës ata kanë hyrë në shtëpinë tonë dhe kanë qenë aty gjatë. Ne atëherë ende nuk kemi komunikuar me ta, tek kur organizata e UNMIK-ut apo s'di kush, nuk e di, mirëpo ajo organizatë e cila është marrë me pronë të tonën të cilën e kemi me tapi, dhe ata na kanë thënë që ai është në banesë dhe ne kemi thënë, "Ok, të paktën e dijmë kush është ai", dhe asgjë tjetër.

Ne e kemi pasur atë banesë, një dyqan e cila ka qenë garazhë pas ndërtesës dhe baba e pat shndërruar në dyqan sikur të gjithë. Në fund atë e shkatërruan, atë nuk ka mundur ta shes, atë e rrafshuan me tokë dhe aty e kanë ndërtuar një shetitore, çka tjetër, e kemi pasur atë shtëpi të cilën baba fatkeqësisht e ka ndërtuar gjithë ato vite. Dhe në fund banesën e kemi shitur, thjeshtë një njeri u lajmërua dhe këtë e zgjidhëm përmes avokatëve, për shumë pak të hollla, por neve na ka ndihmuar t'i kthejmë borxhet, pasi që ne tani ishim në Beograd.

Ne kemi qenë në njërën nga banesat, pronar e së cilës kanë qenë Kariqët, kështu që atë banesë e kemi marrë në përdordim dhe në një moment jemi dashur… ka qenë e vogël, mirëpo e mirë ka qenë dhe i falenderoj shumë për këtë, mirëpo na është dashur të dalim nga aty. Dhe tash, baba ka bërë… baba ka qenë një njeri me shumë lidhje, dhe me vjet u ka bërë mirë njerëzve… dhe tash disa prej atyre të shumtëve i lajmëroheshin atij për t'i ndihmuar. Kështu që, ai mandej e mori pak tokë për pak të holla apo falas. Nuk jam më as i sigurtë dhe ka filluar të ndërtojë atë objekt, ku poshtë e ka një dyqan dhe lartë dy banesa me 50 metra katrorë. Dhe më pas jemi dashur këtë ta rregullojmë shumë shpejt për të

dalur nga ajo banesë. Ai ca të holla edhe i ka huazuar që kjo banesë të rregullohet, dhe më pas të hollat nga banesa në Pejë na kanë ardhur mirë pasi që i kemi kthyer borxhet dhe diçka pak i kemi ruajtur në bank si kursime.

Shtëpinë e kanë ndërtuar prapë, si ta them, ajo shtëpi ka qenë pranë përfundimit. Bukfalisht i ka pasur edhe një javë punë, vetëm të instalohet nxemja dhe të bartemi. Dhe ata e kanë rindërtuar të gjithë atë, sepse nxemjen e kishin marrë, i kishin hequr të gjitha, të gjitha të reja. Kështu që në fund baba e ka shitur të tërën, shtëpinë dhe tokën, njëjtë për pak të holla. Gjatë e ka rezistu këtë sepse ishte e tija, kjo është diçka që e lidhë ate për 'poshtë', mirëpo në atë moment e kuptoi që nuk ka kthim, nuk ka. Të mos e gënjejmë vetën. Ndoshta ai ka shpresuar që dikur pranë fundit, pranë vdekjes shkon 'poshtë', nuk e di çka. Nuk ka, ne jetojmë në Beograd tash edhe nëse shkojmë nga këtu, shkojmë diku më larg, kthim 'poshtë' nuk ka.

Marijana Toma: Më tregove që… më duket që jeta yte ndahet në ate në Pejë dhe në Beograd, me këtë *AIESEC*, më këto udhëtimet dhe të gjitha. Në fakt deshta të të pyes si e ke njoftuar bashkëshortën tënde të tanishme?

Nikolla Jovanovic: Po edhe është ashtu në njëfarë mënyre. Tash, nuk jam i sigurt nëse ka të bëjë me gjithçka që kam përjetuar në Kosovë apo thjeshtë kishte me qenë njëjtë nëse kisha ardhur këtu për të studiuar. Nuk kam lidhje sepse mendoj që kjo në njëfarë forme ka të bëjë me interesimin tim. Nuk është që unë tash, mendoj Ok, nuk shkoj me i mbledh pejanët kjo nuk më intereson. Mua më pëlqen t'i takojë miqtë e mi, mirëpo ata mund t'i shoh edhe përtej kësaj teme, mirëpo t'i takojë e t'i dëgjoj disa, që njëqind njerëz të më pyesin, "Hej a ke shitur diçka atje 'poshtë'?" Nuk mundem këtë. Mirëpo nuk është kjo diçka që i shmangem.

Unë njëmend takohem dhe jam në kontakt me një numër të madh të njerëzve, posaçërisht me gjeneratën time nga shkolla. Prej se Nikolla Rajeviqi ka filluar të na mbledh të gjithëve jemi afëruar dhe shoqërohemi mjaft me njëri tjetrin. Edhepse fëmijët i kemi të moshave të ndryshme, disave fëmijët u shkojnë në fakultet, e unë kishe në rregull. Kështu që, po mendoj, nuk janë botëra të ndara, mirëpo faktikisht miqtë më të afërt i kam ata nga koha e studimevfe dhe *AIESEC*, dhe gjeneralisht nga vendet e ndryshme të punës. Që nga viti 2000 unë punoj, kështu që kam shumë kolegë etj.

Bashkëshorten e kam njoftuar përmes *AIESEC*. Ajo e ka drejtuar zyrën në Nish, unë kam qenë në zyrë në Beograd dhe, po mendoj, jemi njohur përmes organizatës dhe unë kam qenë i angazhuar nga ata si një lloj mentori që t'u ndihmojë, dhe kam kaluar shumë kohë atje poshtë, mirëpo atëherë me të vërtetë kemi qenë miq. Ne tek më vonë, në fakt kur kam shkuar unë për herë të parë në Stamboll, ne atëherë ia patëm filluar të shihemi. Ajo ka ardhur në Stamboll në një konferencë dhe aty ia kemi filluar. Dhe në vitet në vijim kjo ka qenë ajo vuajtja ime, pasi që unë kam qenë Stamboll një vjet e gjysmë, mandej kam ardhur në Beograd, më pas ajo ka shkuar në Paris për një vit e kusur dhe unë kam udhëtuar non-stop.

Unë atëherë veç isha në ERSTE Group dhe e kam përdorur këtë. Gjithnjë bëjë hajgare si ende nuk i kam paguar borxhet e kartelës për gjithë ato udhëtime me aeroplan, mirëpo ia ka vlejtur secili cent. Dhe tek atëherë kur u kthye ajo nga Parisi kemi filluar të jetojmë së bashku. Po të mos ishte *AIESEC* dhe ato studimet, me siguri nuk ishim njohur dhe takuar kurrë, thjeshtë ajo ka qenë në Nish, unë në Beograd.

Por, këtu është një anekdotë. Baba i saj madje edhe kur nuk ishim së bashku, shumë para kësaj unë për shkak *AIESEC*-ut isha në Nish, dhe kisha fjetur tek ta sepse të gjithë sa herë udhëtojmë flejm te

dikush. Dhe atëherë baba i saj më ka zezatë pak, “Eh tash, nuk ka këtu, ke fjetur tek ne tash duhesh të martohesh me të”. Edhe unë e kisha marrë seriozisht, dhe ja. Eh, edhe kjo është anekdotë, baba i saj të dyja vajzave u kishte thënë, “Bëni çfarë të doni, por mos ma bini n’shpi kosovarin edhe malazezin”. Meqenëse tash në Nish ka një numër të madh të kosovarëve dhe malaziasve të cilët studiojnë dhe ata njihen si të egër nëpër kafene. Dhe ja njëra është martuar me malazias dhe tjetra me kosovar.

Marijana Toma: Tash e ke Filipin i cili është?

Nikolla Jovanovic: Dy vjet e gjysmë.

Marijana Toma: Dy e gjysmë. Më the më herët që ekziston mundësia që një ditë nëse shkon në Kosovë ndodh që e merr edhe ate. Dhe kisha dashur të kthehem edhe një herë për fund, cila është gjëja e parë të cilën ia kishe mësuar fëmijës tënd për Kosovën, Pejën?

Nikolla Jovanovic: Po, ai është vendi më i mirë me birrën ma të mirë. Kjo është ajo. Për mua, dhe e them, edhe sa kemi qenë ‘poshtë’ ne gjithnjë kemi bërë hajgare, kemi pasur psudonime për të gjithë ata nga qytetet tjera, dhe gjithnjë kemi bërë hajgare me ta, kjo na ka mbajtur [bashkë], ne ishim më përparimtar se ata, ne ishim perëndimi për të gjithë ata, dhe *de facto* ne kemi qenë perëndimi i Kosovës. Dhe e ka pasë njëfarë kulture të cilën edhe sot e shoh kur takoj grupe të tilla, shpesh sheh njerz si shoqërohen me njëri tjetrin vetëm pse janë nga Kosova. Dhe thjeshtë njerëz që sikur ata kanë kaluar nëpër gjëra të njëjta e tjerë, dhe atëherë më lehtë shoqërohen. Ndërsa pejanët, thjeshtë shoqërohen vetëm me pejanë. Nuk shoqërohen me askend tjetër nga Kosova pos me pejanë. E tillë është ajo kultura jonë.

Dhe mendoj që nëse ndonjëherë e marrë me veti Filipin, dua që ai ta vërej këtë më së pari, që me të vërtetë Peja është qytet i bukur, me pamje nga Rugova, Patriarshinë e Pejës, e cila është një vend i veçantë. Mua më kujtohet njëjtë që si i vogël më është dukur çuditshëm kur na tregonin që këtu vijnë njerëzit nga vendet e ndryshme të botës, nga religjione të ndryshme, vijnë këtu dhe luten jo pse janë pagëzuar aty, sepse ta them të drejtën për mua nuk ka rëndësi, mirëpo sepse është një vend i veçantë i kulturës dhe i historisë, nëse për asgjë tjetër.

Madje, as nuk kam në mendje ndonjë histori të veçantë, mirëpo aty po krijohet historia. Ai është një vend i cili është një shembull fenomenal se në çfarë mënyre duhet funkcionuar, në çfarë mënyre të paktën duhet munduar të integrohesh në komunitetin lokal, irelevante nëse ajo është Republika e Kosovës, Republika Metohija apo Serbija, jo thjeshtë pse kjo është kjo. Pra kur ta marrë Filipin me siguri do të jetë ky rrafsh, Peja, Deçani, Prizreni, i cili është qyteti më i bukur, por për mua natyrisht i dyti më i bukur në botë, dhe kjo është e tëra.

Marijana Toma: A ka diçka që do të dëshirojë të shtoje?

Nikolla Jovanovic: Po, lidhje nuk kam, nuk e di, gjeneralisht të them, po mendoj do të doja…. Kur po mendoj për këtë që më është dashur të vijë këtu dhe ta bëjë këtë, nuk e kam ditur çfarë të pres nga kjo, as nuk kam dashur, kam dashur të përgaditem së pari, prit, të flas për këtë apo atë, por e kuptova që jo. Do të lejojë ty ta udhëheqës, po mendoj ashtu është më mirë dhe që njëmend këto të jenë kujtimet e mia. E tëra çfarë kam thënë janë gjëra tëpër subjektive, të shikuara nga kandi im. Ndoshta edhe disa gjëra të cilat kanë qenë të rëndësishme për mua dhe unë i ka… ashtu i mbaj në mend.

Mendoj që është me rëndësi të flitet për tërë këtë, mendoj që është me rëndësi t'i dëgjojmë tregimet e njëri tjetrit. Po mendoj, të shohim që të gjithë kemi kaluar nëpër gjëra të ngjashme… sepse unë ende kam miq që vijnë nga Peja, ju tregova që vijnë tek ne. Dhe ju dëgjoni nga ata tregime. Nuk është që tash atje 'poshtë' është mjaltë dhe qumësht, ata përjetojnë gjëra të tmerrshme ende. Ato janë shantazhet, ashtu është kur ke biznesin tënd, këta miqtë tanë të gjithë janë biznesmenë, dhe ti duhet të paguash një lloj haraçi. Këta janë Shoqatat e Veteranëve të UÇK-së, këto shoqata, dhe duhesh të paguash. Përndryshe të bëjnë vërejtje vetëm pse je i tillë, dhe mund të ta gjuajnë dyqanin me gurë dhe çkado tjetër, presioni është i madh.

Edhe kjo më duket interesant, që e sheh njëfarë nostalgjie prej anës së tyre. Prapë them këta janë disa njerëz nga Peja. Këta janë njerëzit tanë. Këta nuk kanë qenë ata njerëz të cilët kanë menduar a duhet Kosova të bëhet e pavarur, të bëhet shtet dhe që ia vlen të shkosh në luftë për këtë. Këta janë njerëz të cilët… ne kemi jetuar me ta së bashku. Atyre tash, ne atyre u mungojmë sikurse ata neve. Pra ato janë lidhje miqësore. Dhe dëshiroj që sa më shumë t'u ipet mundësia, siç më është dhënë mua mundësia që ta tregojë përvojën time, që ata njerëz t'i tregojnë tregimet e tyre sepse ne nuk kemi shumë mundësi të flasim me njëri tjetrin.

Zakonisht ose flasin qeveritë apo ndonjë organizatë të cilat janë serbe në Serbi, të cilat përjetohen si tradhtare, të Kosovës në Kosovë që poashtu përjetohen si tradhtare. Dhe kjo nuk është mirë, po mendoj, nuk është e shëndetshme dhe kjo nuk do të na…. Këto janë organizata njëjtë shumë të rëndësishme apo jo, sepse mbledhin të dhëna për të zhdukurit e tjerë, por mendoj që këtu duhet japur mundësia sa më shuimë njerëzve të thjeshtë që ata tash të…. Tash nuk e di se në çfarë forme, të mos hyjmë në këtë, por mendoj që kjo nuk është forma e vetme që ne të kuptojmë që ne në fakt jemi të njëjtë, që njëjtë na keqtrajtojnë qeveritë tona, që njëjtë kalojmë nëpër secilat zgjedhje, nacionalizëm edhe te ata edhe te na dhe kjo askujt asgjë të mirë nuk i ka sjellë. Na bllokojnë për shkak të kësaj, sidomos ata në Kosovë. Pasaportat, vizat, nuk e di. Neve më pak ato vizat, mirëpo ka mjaft paragjykime ndaj neve për shkak të gjithave, andaj mendoj që sa më shumë komunikim, mendoj që kjo është e vetmja mënyrë përpara. Ja pra.

Marijana Toma: Shumë faleminderit, Nikolla.

Nikolla Jovanovic: Faleminderit prej teje.